



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Avokaturën e Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË PËR ECURINË E
DETYRIMEVE SHTETËRORE PËR VENDIMET E FORMËS SË
PRERË TË GJEDNJ DHE ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR”**

NË

AVOKATURËN E SHTETIT

Tiranë, dhjetor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-8
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-9
II.	HYRJA	9-10
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	10
2.	Identifikimi i çështjes	10
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4.	Përgjegjësitë e audituesve	11
5.	Kriteret e vlerësimit	11
6.	Standardet e auditimit	11
7.	Metodat e auditimit	11-12
8.	Dokumentimi i auditimit	12
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimit të auditimit:	12
2.1	Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2023. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare)	12-36
2.2	Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.	36-45
2.3	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	45
IV	REKOMANDIME	45-49

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Avokatura e Shtetit (*këtu e më poshtë ASH*) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror.

Auditimi i këtij institucioni ka **rëndësi** pasi një ndër funksionet bazë të tij është mbrojtja e interesave pasurore të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Qëllimi i këtij auditimi, synon në dhënien e konkluzionit mbi ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, si dhe kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2023. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

- Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Metodat për kryerjen e këtij e auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, ASH, funksion në zbatim të Ligjit Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

c. *Pyetësorët drejtuar subjektit*- duke marrë informacionet mbi numrin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet përkatëse për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, këmbimin e informacionit me institucionet përgjegjëse/palë interesi në çështje arbitrazhi;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

I.1 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi në terren.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Avokatura e Shtetit për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023, paraqet në veprimtarinë e saj specifika trajtuar më poshtë. Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në vijim:

I. Nga auditimi mbi ecurinë e ekzekutimit të vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar të cilat deri në datë 31.12.2023 rezultojnë në proces njohje/njohur nga Gjykata e Apelit për marrje fuqi juridike vendimi u konstatua:

- për 2 vendime arbitrazhi (*ICCCase 22919/GR dhe ICSID ARB/14/26*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që kanë paditësit ndaj Republikës së Shqipërisë, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i palës së paditur (*RSH/MIE,MTM*) për procedurat e njohjes të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile (KPrC), neni 393 dhe 398, e cila ka sjellë si pasojë mos arkëtimin në buxhetin e shtetit të vlerës 10,013,972 Euro, 1,162,125.71 USD dhe 108,550.6 GBP.

- për 4 vendime arbitrazhi (*ICSID Case ARB/15/28, ICC Case 22676/GR GBC, ICC Case 23998/MHM dhe ICC Case 20564*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që ka Republika e Shqipërisë ndaj paditësve, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i paditësve, në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit në zbatim të nenit 398 K.Pr.Civile, që ka sjellë si pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH ndaj tyre, në vlerën 108,439,747.08 Euro dhe 59,479,735.64 USD. Krahas detyrimeve sipas vendimeve të arbitrazhit, janë dhe interesat në varësi të çështjeve dhe konkretisht:

- për çështjen *ARB/15/28* kemi interesa mbi shumat e dispozitivit të vendimit *Libor+3%* tremujor prej 31.03.2018 deri në pagesën e plotë gjithashtu dhe interesa nga procesi i Anullimit, interes *LIBOR* (ose *SOFR* nëse *LIBOR* nuk ekziston më derisa të bëhet pagesa e plotë) + 3% tremujor nga data 31 mars 2021.
- për çështjen *22676/GR GBC*, interesi me normë 5% do të llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës për shumat 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro,
- për çështjen *Case 23998/MHM dhe ICC Case 20564* Tribunali nuk është shprehur për penalitete.

II. Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve GJEDNJ, rezultoi:

- Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat për 21 vendime të dala në vitin 2023, duke përfshirë dhe vendimin “*Durdaj kundër Shqipërisë*”, i cili është bërë përfundimtar në vitin 2024. Në 6 procedura të vitit 2023, ekzekutimi është kryer jashtë afatit.

-Për 3(tre) vendime (*D. kundër Shqipërisë*-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 14.09.2015, *Dh. N. kundër Shqipërisë*-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 17.03.2016 dhe *Sh. kundër Shqipërisë*, vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 28.05.2018 në vlerën totale 17,880,650 Euro, detyrim i cili vijon të jetë i pa ekzekutuar.

- Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë 3(tre) vendime të GJEDNJ-së, të mbartura (“*S. kundër Shqipërisë*”, “*P. kundër Shqipërisë*” dhe “*S. kundër Shqipërisë*”), duke shkaktuar detyrimin për kryerjen e pagesave për interesa në total 410,937 lekë.

III. Nga auditimi mbi hedhjen e të dhënave në regjistrin e posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, rezulton se Regjistri nuk është plotësuar sipas rubrikave të formatit të miratuar, pasi nuk përmban të dhëna mbi datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes/vendimit për arbitrazh në protokoll, për çështje të iniciuara para vitit 2022 (*kohë në të cilën ka dalë urdhëri për miratimin e formatit të Regjistrit*) për aq sa mund të lejohet nga parimi i konfidencialitetit, si dhe për ekzekutimin e detyrimeve të GJEDNJ, Regjistri nuk është plotësuar sipas formatit të miratuar, duke mos përfshirë numrin e kërkesës, jo në përputhje me nenin 17 pika 3, germa “c” dhe nenin 18, pika 1.2, germa “r” të Rregullores dhe formatit të Regjistrit.

IV. Nga krahasimi i të dhënave të dërguara nga Avokatura e Shtetit në Ministrinë e Financave (MF) me shkresën Nr.17/1, datë 19.04.2024, për detyrimet nga vendime të arbitrazhit me të dhënat e administruara nga ASH deri me 31.12.2023 si dhe ato të publikuara si pjesë e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023 (*këtu e më poshtë Raporti*) “*Detyrime të tjera kontigjente*” rezulton:

Raportimi nga Avokatura e Shtetit është bërë në mënyrë periodike 2 herë në vit buxhetor (brenda datës 10 Maj dhe 10 Shtator), ndërsa të dhënat e publikuara nga MF në Raport, përfshijnë detyrimet deri në Prill 2024 dhe jo detyrimet deri në 31.12.2023. Referuar shkresës Nr. 1795/Iprot., datë 19.04.2024 të ASH raportohen për Ministrinë e Financave në kuadër

të përgatitjes së dokumentit të “Deklaratës së Risqeve Fiskale për vitin 2023” detyrimet e përfshira deri në datën e raportimit (prill 2024) dhe jo deri në datën 31 Dhjetor 2023, megjithëse nga MF janë kërkuar të dhëna deri në këtë datë. Për rrjedhojë, konstatohet pasaktësi në vlerën e detyrimit që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse në vlerën 13,492,241 Euro nga ASH.

Detyrimi i RSH që rrjedh nga vendimet e Arbitrazhit deri në datën 31 Dhjetor 2023, në total, duhet të ishte 169,759,855 Euro (183,252,095-13,492,241), përfshirë kostot administrative, ligjore dhe të pa likuidara, ndërkohë që në Raportin e MF “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjate vitit 2023”, këto detyrime në total raportohen 183,252,095 Euro (njësuar në monedhë të vetme Euro).

Nga ASH, të regjistruara detyrimet (dëmshpërblimi) e Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga vendime finale (përfundimtare) deri 31.12.2023 (pa kostot administrative dhe ligjore) janë në vlerën 108,439,747.12 Euro dhe 59,479,736.64 USD, ndërsa në Raportin e MF shprehen në monedhë Euro.

Më konkretisht nga krahasimi i të dhënave të raportuara nga ASH dhe atyre të publikuara në Raportin e MF:

- për çështjen **ICC Case 24140/MHM**, në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023, në kolonën “detyrimi i faturuar” që nënkupton detyrimin nga vendimi final i arbitrazhit, rezultojnë vlera 13,492,241 Euro, ndërkohë që deri në 31.12.2023 në të dhënat e ASH kemi vetëm detyrim të pretenduar (rreth 35,000,000 Euro, si dhe RSH me kundërpadi dhe minimumi që paditësi i detyrohet RSH, kuantifikuar në vlerë rreth 36,413,664.45 Euro) pasi nuk ka një vendim final arbitrazhi, vendimi ka dalë me 14.03.2024 duke u shprehur për detyrimin në vlerën **13,492,241 Euro** i cili është raportuar nga ASH në MF në Prill 2024.

Nga ASH janë raportuar në Prill 2024, shpenzime përfaqësimi dhe gjyqësore 1,101,647 Euro, shpenzime ekspertimi dhe administrative 785,700 USD si dhe 7612.5 GBP shpenzime gjyqësore, ndërsa në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023 publikuar nga MF raportohen kosto administrative të përfaqësimit dhe kosto ligjore 28,500 Euro të pa likuiduara. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje AKUK, Avokatura e Shtetit nuk ka informacion nga ky institucion.

- për çështjen **ICC Case 23998/MHM** në Raportin Vjetor në kolonën “detyrimi i faturuar” rezultojnë vlera 42,472,629 Euro, ndërkohë në të dhënat e administruara nga ASH deri në 31.12.2023 si dhe ato të raportuara në Prill 2024, kjo vlerë është 44,264,681.41 USD dhe 573,081.13 Euro. Në lidhje me kostot ligjore dhe administrative për këtë çështje nga ASH nuk rezultojnë të jetë raportuar për to, me arsyetimin se nuk kanë ardhur fatura të tjera për likuidim duke e quajtur detyrim të mbyllur, ndërkohë në Raportin e MF këto detyrime rezultojnë në vlerën 225,000 Euro të pa likuiduar akoma. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur, nga institucioni palë në çështje/ARRSH, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.

-për çështjen **ICSID ARB/15/28**, në Raport në kolonën “detyrimi i faturuar” nuk është vendosur asnjë vlerë mbi detyrimet që rrjedhin nga vendimi final i arbitrazhit i cili është në proces njohje në Gjykatën e Apelit për të marrë fuqi juridike që në vitin 2020, ndërkohë nga ASH është raportuar në Prill 2024 dhe jo me 31.12.2023, detyrimi që rrjedh nga vendimi final i arbitrazhit duke u shprehur “rreth 108,000,000 Euro”, pra jo me saktësi në një vlerë prej 290,764.5 Euro, pasi vendimi i arbitrazhit shprehet për vlerën 107,709,238.5 Euro, 2,346,442.13 USD (dëmshpërblim dhe kosto administrative e ligjore). Gjithashtu nga ASH janë raportuar në MF, kosto përfaqësimi për kundërshtimin e ekzekutimit të arbitrazhit në total 2.176,404 Euro dhe 700,000 GBP, si dhe kosto përfaqësimi për procedurat e rishikimit të vendimit të arbitrazhit në vlerën 950,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF rezultojnë vlera 1,698,417 Euro e pa likuiduar si kosto ligjore.

- për çështjen **ICC Case 22919/GR**, ASH nuk ka raportuar kosto administrative dhe ligjore, ndërkohë në Raportin e MF publikohen 111,150 Euro të pa likuiduar. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje/MIE, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.
- për çështjen **ICSID ARB/20/37**, ASH ka raportuar kosto ekspertimi 360,000 Euro, ndërsa në Raportin e MFE publikohen 690,000 Euro të pa likuiduar (kosto administrative dhe ligjore). Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje APD, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.
- për çështjen **ICCD 22676/GR**, ASH ka raportuar detyrimin nga vendimi final i arbitrazhit që ka Republika e Shqipërisë në total në vlerën 12,870,612.1 USD dhe 14,451.68 Euro, ndërsa MF raporton 12,241,533 Euro.
- për çështjen **ICC 21349/GR**, ASH ka raportuar kosto përfaqësimi 175,000,000 Euro dhe 880,000 USD, ndërkohë në Raportin e MF, pasqyruar kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit në vlerën 390,764 Euro të pa likuiduara. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje MIE/AKBN,/Albpetrol, ASH nuk ka informacion nga këto institucione.
- për çështjen **SCC 2021/155**, ASH ka raportuar kosto ekspertimi 610,028 Euro, shpenzime gjyqësore 2630.35 Euro dhe 1300.09 GBP, si dhe kosto përfaqësimi 1,650,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF, kosto paraprake dhe ligjore pasqyruar në vlerën 973,886 Euro si detyrime të pa likuiduara. Nuk ka informacion nga MF si palë në proces.
- për çështjen **M. N. kundër RSH**, ASH raporton kosto përfaqësimi 675,000 Euro dhe shpenzime gjyqësore 100,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF raportohen 645,000 Euro kosto përfaqësimi të palikuiduara. Nuk ka informacion nga MF si palë në proces.
- për çështjen **PCA Case 2028-49**, ASH ka raportuar kosto përfaqësimi 750,000 Euro, ndërsa në Raportin MF rezulton 200,000 Euro kosto administrative dhe ligjore të pa likuiduara.

V. Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administron Avokatura e Shtetit për çështjen **ICSID ARB/14/26** “A.A.” SHPK, etj. kundër RSH/Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit(MTM), Tribunali Arbitrazhit është shprehur në favor të Republikës së Shqipërisë/MTM.

Pala paditëse ka iniciuar procesin e anulimit për të cilin tribunali i arbitrazhit ka dalë me Vendim datë 18.04.2022 njoftuar palëve me 6 Maj 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023 të MTM-së rezultoi se, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, tepricat e llogarive rezultojnë me vlerë 0 (zero) lekë.

Nga përllogaritja e grupit të auditimit deri me datë 31.12.2023 totali i vlerave të arkëtueshme në favor të MTM është në shumat 5,418,883.31 Euro, 1,472,635.27 USD dhe 265,458.19 GBP, përbërë nga totali i të drejtave të principalit në shumën 2,407,000 Euro, 837,125.71 USD dhe 106,755 GBP, si dhe interesa në shumat 3,011,883.31 Euro, 635,509.56 USD dhe 158,703.19 GBP.

Nga shpallja e vendimit dhe deri në datën 31 dhjetor 2023 nga ana e MTM nuk është marrë asnjë masë për njohjen e vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit për dhënie fuqi ligjore në mënyrë që, të bëhet kontabilizimi dhe më pas ndjekja për ekzekutimin e tij.

VI. Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administron Avokatura e Shtetit rezulton se për dy çështje në arbitrazhin ndërkombëtar (**ICC Case 22676** dhe **ICC Case 20564/EMT/GR**).Tribunali Arbitrazhit shprehet:

1. Për çështjen ICC Case 22676/GR detyrimi i RSH (*MIE/AKBN*) ndaj paditësit është 12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+ interesa.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, me kërkesë të shoqërisë “G.” **ka njohur vendimin e arbitrazhit duke i dhënë fuqi juridike**. Avokatura e Shtetit ka ushtruar rekurs dhe aktualisht çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë.

Nga përlllogaritja e grupit të auditimit deri me datë 31.12.2023 totali i detyrimeve rezulton të jetë 12,921,664.63 USD dhe 16,971.82 Euro. Interesat e përlllogaritura deri me datë 31.12.2023, janë 2,520.14 € dhe 51,052.53 USD.

Detyrimet që rrjedhin nga vendimi nuk janë njohur në pasqyrat financiare të MIE duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të detyrimeve që ky institucion ndaj palëve të treta. Gjithashtu në pasqyrat financiare detyrimi dhe interesat të cilat shtohen me normë 5% deri në shlyerje, sjellin rritje të risqeve financiare me të cilat përballet institucioni.

2. Për çështjen **ICC Case 20564/EMT/G**, Tribunali Arbitrazhit shprehet për detyrime si më poshtë:

-T'i paguhen Republikës së Shqipërisë penaltitetet për vonesa në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë.

- Dëmshpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 9.1.2018 deri në pagesën e plotë

- Rimbursim të RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC

- Detyrim i RSH për t'i rimbursuar Paditësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën 142,975.78 Euro

Gjykata e Apelit me vendimin nr. 131, datë 03.05.2023 i ka dhënë fuqi ligjore vendimit. Detyrimet që rrjedhin nga vendimi nuk janë njohur në pasqyrat financiare të MIE duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare të të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasojë mos arkëtimin e të drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

VII. Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administrojnë Avokatura e Shtetit rezulton një çështje **ICC Case 21349/GR** kundër MIE/AKBN në Arbitrazhin Ndërkombëtar e përfunduar me palë të paditur Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023, të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore rezultoi se në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve është kontabilizuar detyrimi. Tribunali Arbitrazhit ka dalë me vendim të ndërmjetëm datë 01.02.2018 sipas të cilit:

-AKBN detyrohen t'i paguajnë B. vlerën 1,161,309,37 USD, kostot e përballuara nga B. deri në këtë fazë të procedurave në lidhje me ankimimin.

Deri me datë 31.12.2023 nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore nuk është marrë asnjë masë lidhur me likuidimin apo planifikimin për likuidim të këtij detyrimi, i cili nuk parashikon penaltitet për mos pagesa.

VIII. Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administrojnë Avokatura e Shtetit rezulton se nuk ka çështje që i përket ALBPETROL SHA-Patos, si dhe në pasqyrat financiare për vitin 2023, tek llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të ALBPETROL-SHA Patos nuk ka vendime të kontabilizuara.

IX. Për vitin 2023, rezulton se nuk ka funksionuar Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ, pasi janë bërë ndryshime në përbërjen e anëtarëve.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

I. Rekomandimi 1.1: Të merren masa nga Avokatura e Shtetit/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, për këmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin me palët e interesit/ministritë përgjegjëse, në lidhje me procedurat e ndjekura prej tyre për ecurinë e procesit të njohjes së vendimeve nga Gjykata e Apelit për rastet kur vendimet e arbitrazhit janë shprehur në favor të RSH.

II. Rekomandimi 2.1: Të merren masa nga ASH në të ardhmen, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të kryhen veprimet me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ brenda afatit ligjor.

III. Rekomandimi 3.1: Të merren masa nga ASH/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, që hedhja e të dhënave në regjistrin e çështjeve të bëhet konform kërkesave të formatit të miratuar, duke u bërë përditësimi i tij në kohë reale, me qëllim që të dhënat e regjistruara të shërbejnë për raportimin në MFE të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

IV.Rekomandimi 4.1:Të merren masa nga ASH që në bashkëpunim me MF dhe ministrinë palë në proces arbitrazhi, të bëjë rakordimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ duke raportuar edhe për të dhënët që ato administrojnë deri në mbyllje të vitit buxhetor, me qëllim raportimin sa më të saktë mbi realizimin e buxhetit faktik të vitit buxhetor.

V.Rekomandimi 5.1: Të merren masa nga Avokatura e Shtetit që në bashkëpunim me institucionet palë në proces arbitrazhi (MTM, MIE, AKBN) të rakordojnë veprimet duke filluar që nga ndjekja e procedurave ligjore në Gjykatën e Apelit për dhënie fuqi ligjore vendimit të arbitrazhit, me qëllim njohjen e të drejtave dhe detyrime në pasqyrat financiare të tyre, për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare. Bashkëpunimi mes institucioneve dhe ASH në lidhje me likuidimin e detyrimeve dhe marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve do i shërbejë raportimit që Avokatura e Shtetit bën pranë Ministrisë së Financave për hartimin e Raportit Vjetor për zbatimin e buxhetit faktik.

VI.Rekomandimi 6.1: Të merren masa që Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit, për hartimin e planeve të punës dhe plan veprimet në kuadër të ekzekutimit të vendimeve.

1.3. Konkluzion i përgjithshëm i auditimit.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit (këtu e më poshtë ASH), me kriteret e vlerësimit që përfshijnë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, në tërësi ka rezultuar se veprimtaria e Avokaturës së Shtetit është në përputhje me Ligjin Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” si dhe Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit” i ndryshuar me të gjitha aspektet materiale, duke veçuar çështjet e rezultuara më poshtë nga:

- Mos rakordimi i të dhënave që rezultojnë deri 31.12.2023 me ato të raportuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe publikuar në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023, për shkak të përfshirjes së të dhënave të raportuara deri në Prill 2024 nga ASH dhe jo deri në 31.12.2023, duke sjellë pasaktësi në vlerën e detyrimit të raportuar që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse në vlerën 13,492,241 Euro.

-Nga metoda jo e njëjtë e përdorur për raportimin e të dhënave, pasi Avokatura e Shtetit raporton të dhëna referuar dispozitivit të vendimeve të arbitrazhit (në monedhat përkatëse) të cilat rezultuan në përputhje me këto vendime, ndërsa MF raporton të dhëna duke përfshirë dhe detyrime të mbartura të pa likuiduara, në lidhje me kostot administrative, ligjore dhe ekspertimin (njësuar në një monedhë të vetme Euro). Për rrjedhojë, detyrimi i Republikës së Shqipërisë (RSH) që rrjedh nga vendimet e Arbitrazhit deri në datën 31 Dhjetor 2023, në total, duhet të ishte 169,759,855 Euro (183,252,095-13,492,241), përfshirë kostot administrative, ligjore dhe të pa likuiduara, ndërkohë që në Raportin e MF “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor,

situatën makroekonomike dhe fiskale gjate vitit 2023”, këto detyrime në total raportohen 183,252,095 Euro (njësuar në monedhë të vetme Euro).

- Nga auditimi mbi ecurinë e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar rezulton se:

- për 2 vendime arbitrazhi (ICC Case 22919/GR dhe ICSID ARB/14/26) për të cilat paditësi ka detyrime ndaj RSH, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit/të paditurve (RSH/MIE,MTM) në lidhje me procedurat e njohjes të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, duke mos u arkëtuar në buxhetin e shtetit vlera 10,013,972 Euro, 1,162,125.71 USD dhe 108,550.6 GBP.

- për 4 vendime arbitrazhi (ICSID Case ARB/15/28, ICC Case 22676/GR, ICC Case 23998/MHM dhe ICC Case 20564) për të cilat RSH ka detyrime ndaj paditësve, ka vonesa në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit nga mosveprimi në kohë i paditësve, që ka sjellë si pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH ndaj tyre, në vlerën 108,439,747.08 Euro dhe 59,479,735.64 USD.

-Për 1 çështje (ICC Case 22676/GR) detyrimi i RSH (MIE/AKBN) sipas vendimit të arbitrazhit është 12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+interesa, dhe nga përlogaritja e kryer nga auditimi deri më datë 31.12.2023, totalit të detyrimeve i shtohen 2,520.14 Euro dhe 51,052.53 USD. Këto detyrimet që rrjedhin nga vendimi i arbitrazhit nuk janë njohur dhe reflektuar në pasqyrat financiare të MIE, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të detyrimeve që ka ky institucion ndaj palëve të treta. Gjithashtu, në pasqyrat financiare detyrimi dhe interesat të cilat shtohen me normë 5% deri në shlyerje, sjellin rritje të risqeve financiare buxhetore me të cilat përballet institucioni.

- Për çështjen ICC Case 20564/EMT/G., detyrimet që rrjedhin nga vendimi nuk janë njohur dhe reflektuar në pasqyrat financiare të MIE, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare të të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasojë mos arkëtimin e të drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

- Nga ekzekutimi i vendimeve GJEDNJ, për 21 vendime të dala në vitin 2023, duke përfshirë dhe vendimin ”D. kundër Shqipërisë”, i cili është bërë përfundimtar në vitin 2024, Avokatura e Shtetit ka iniciuar dhe për 6 procedura të vitit 2023, ekzekutimi i të cilave është bërë jashtë afatit përkatës ligjor.

- Për 3(tre) vendime përfundimtare të mbartura, detyrimi i vendosur nga GJEDNJ vijon të jetë i pa ekzekutuar duke shkaktuar rritjen e interesave për mos likuidimin në kohë. Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë 3 (tre) vendime të GJEDNJ-së, të mbartura duke shkaktuar detyrimin për kryerjen e pagesave për interesa në total 410,937 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr.853/1 prot., datë 01.07.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 03.07.2024 deri në datë 06.09.2024, në subjektin Avokatura e Shtetit (*këtu e më poshtë ASH*) u krye auditimi i përputhshmërisë për periudhën e aktivitetit të subjektit nga 01.01.2023 deri në 31.12.2023 nga grupi i auditimit me përbërje:

1.M. H.	Përgjegjës grupi;
2.E. Sh.	auditues
2.A. Z.	auditues
3.A. C.	auditues
4.J. K.	auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: regjistrimin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ, korrespondencën me institucionet palë interesi në çështjet e iniciuara për arbitrazh në lidhje me njohjen e vendimeve të arbitrazhit dhe ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, detyrimin për raportimin në MFE të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet, si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren (ASH) me datë 06.09.2024 me Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe përfaqësuesit të zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, si dhe grupit të auditimit, të cilat kanë shërbyer për hartimin e Projektraportit të Auditimit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 2/2) parashikuar në “*Rregulloren e Procedurave të Auditimit*”, miratuar me Vendimin Nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar.

OBJEKTIVAT, FUSHË VEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e konkluzionit të auditimit të përputhshëmrisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga ASH të rregullave, ligjeve. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e ASH për periudhën në auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- nëse janë zbatuar detyrimet ligjore të Avokaturës së Shtetit në lidhje me regjistrimin në kohë të çështjeve të iniciuara për arbitrazh dhe vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ, si dhe bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (palë interesi në çështje arbitrazhi) për ecurinë e ekzekutimit të vendimeve;
- nëse janë është bërë nga MIE, MTM, AKBN dhe Albetrol SHA-Patos, kontabilizimi i detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ si dhe masat për likuidimin e tyre;
- dhënien e konkluzionit të përgjithshëm të auditimit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së ASH-së.

2. Identifikimi i çështjes.

Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi auditimin e përputhshëmrisë së veprimtarisë së ASH Tiranë, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me ecurinë e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe arbitrazhit;
- bashkëpunimin me institucionet palë interesi;
- përputhshmëria në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të ASH, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në lidhje me përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/ASH dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit/konkluzionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit/konkluzioni. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-^{së}) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për administrimin dhe përditësimin e regjistrit të posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatavetë huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar.

- Nëse janë raportuar në në MFE detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

- Nëse janë kontabilizuar dhe marrë masa për likuidimin e detyrimeve.

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;

-Rregullore e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, e ndryshuar;

- Akte të tjera ligjore/nënligjore që shërbejnë në realizimin e aktivitetit të subjektit të sipërcituar.

6. Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

- ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;

- Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.;

7. Metodot e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arrijtjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, ASH, funksionon në zbatim të Ligjit Nr. Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Pyetësorët drejtuar subjektit*-duke marrë informacionet mbi numrin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ për vitin 2023, këmbimin e informacionit me institucionet përgjegjëse/palë interesi në çështje arbitrazhi;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e ASH, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt-konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e Projektraportit të Auditimit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Avokatura e Shtetit (ASH) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, është institucion qendror i administratës publike, *i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike*, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror. Ajo drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele: në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror përbëhet nga: a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare; b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror; c) *zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar*; ç) zyra e inspektimit; d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit. Detyrat dhe funksionet parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Institucionit. Funksionet bazë të Institucionit janë mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 853/1 prot., datë 01.07.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Avokaturën e Shtetit, si dhe në subjektet MIE, MTM, AKBN dhe ALBPETROL SHA-Patos, u ushtrua auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, sipas këtyre drejtimeve:

- Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2023. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

- Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

- Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

2.1 Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi.

Në zbatim të pikës 2.1 të programit të auditimit “*Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri elektronik dhe fizik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar;
- Korrespondenca e ASH me ministrinë/institucionet e tjera që janë palë në gjykim/arbitrazh;
- Çdo dokumentacion në funksion të kësaj çështjeje auditimi.

Ecuria mbi ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Një ndër funksionet e Avokaturës së Shtetit në zbatim të Ligjit Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar, është përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhet nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

Në funksion të këtij detyrimi ligjor, pranë zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, bazuar në kërkesat e Rregullores së brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, neni 17, pika 1.

Me Urdhrin Nr.375/2 prot., datë 16.11.2022 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është miratuar formati i Regjistrit fizik dhe elektronik i çështjeve të arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja (*këtu e më poshtë Regjistri*).

Gjetja 1: Regjistri nuk është plotësuar sipas rubrikave të formatit të miratuar, pasi nuk përmban të dhëna mbi datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes/vendimit për arbitrazh në protokoll, për çështje të iniciuara para vitit 2022 (*kohë në të cilën ka dalë urdhëri për miratimin e formatit të Regjistrit*) për aq sa mund të lejohet nga parimi i konfidencialitetit, jo në përputhje me kërkesën e nenit 17 pika 3, germa “c” dhe nenit 18, pika 1.2, germa “r” të Rregullores dhe formatit të Regjistrit, sipas të cilës “Çdo vendim arbitrazhi i komunikohet Drejtuesit të zyrës dhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nga avokati i shtetit i ngarkuar me çështjen dhe bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e çështjeve, për aq sa është e mundur nga parimi i konfidencialitetit”. Hedhja e të dhënave në Regjistër është kompetencë e juristit të ngarkuar në zbatim të urdhrin respektiv të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.6, datë 06.09.2024, nga Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.M.I., me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024 si dhe me shkresën Nr. 3316/6 prot., datë 01.11.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/11prot., datë 04.11.2024 është bërë observacion në lidhje me Projektraportin e auditimit nga grupi i punës znj. M. I. dhe E. D., Avokat Shteti.

Pretendimi subjektiv:

1. “... miratimi formatit të regjistrit dhe mbajtja e regjistrit të posaçëm fizik ...sikurse ju keni evidentuar është bërë në vitin 2022....Për çështjet e trajtuara të arbitrazhit përpara vitit 2022, të dhënat e regjistruara në regjistër janë për një periudhë të kaluar kohore... me aq të dhëna që janë gjetur nëpërmjet protokoll-arkivit...Pra, mungesa e plotësimit të informacionit në rubrikat përkatëse të formatit është për shkaqe logjistike...për të cilat nuk ka pasur rregulla të përcaktuara në mbajtjen e të dhënave...Në çdo rast personat përgjegjës janë angazhuar në kërkim të informacionit për periudhat e kaluara dhe me gjetjen e tij do të pasqyrohet në regjistrin e posaçëm”.

2. “Sa i përket konstatimit “që sjell njoftimin në kohë të palëve të interesuara mbi një iniciim arbitrazhi...” sqarohet se ...Regjistri i posaçëm ... është një regjistër që mbahet për efekt të

brendshëm të Avokaturës së Shtetit... janë palët e paditura të cilat njoftojnë Avokaturën e Shtetit...”.

3. *”Në lidhje me rekomandimet për marrjen e masave për Rekomandimin 3.1 sqarojmë se... miratimi i formatit është bërë në vitin 2022, si rezultat i rekomandimeve të mëparshme të KLSH...”.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Në lidhje me pretendimin Nr.1, sqarojmë se nga KLSH është evidentuar fakti që formati i Regjistrimit të çështjeve është miratuar në vitin 2022, por plotësimi i këtij regjistri nuk është bërë konform të gjithë kërkesave të formatit të miratuar për ato çështje të cilat janë trashëguar pas miratimit të formatit, pra pas vitit 2022, në këtë aspekt pretendimi **merret** pjesërisht në konsideratë deri sa të plotësohen të dhënat e kërkuara në formatin e Regjistrimit sipas pretendimit të subjektit.

- Në lidhje me pretendimin Nr.2, sqarojmë se, argumenti juaj në lidhje me njohjen e Avokaturës së Shtetit nga palët e interesit për çështje arbitrazhi të iniciuara, të cilat pastaj regjistrohen nga ASH në këtë Regjistër, **merret** në konsideratë vetëm për momentin e njoftimit nga palët e interesit, por **nuk merret** në konsideratë për aq kohë sa, hedhja e të dhënave nga Avokatura e Shtetit nuk bëhet konform kërkesave të formatit tip dhe për aq kohë sa këto të dhëna nuk janë vetëm për “efekt të brendshëm”, siç ju pretendoni, por shërbejnë për hartimin nga Ministria e Financave e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik, në zbatim të UMF Nr.9 datë 20.03.2018”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe UMF Nr.2, datë 19.01.2023, pika 126.5, germa ”c”, ku, Avokatura e Shtetit dërgon **regjistrin** e përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ, në të cilat përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queu)”.

- Në lidhje me pretendimin Nr.3, sqarojmë se, argumenti juaj është i njëjtë me atë të parashtruar për konstatimin e KLSH-së, i cili është argumentuar në pikën 2 të qëndrimit të grupit të auditimit.

Sipas Kodit të Procedurës Civile (KPrC), neni 393 *“vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim, ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes. Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj”* dhe neni 398 *“Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi”.*

Në kuptim literal, të neni, vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të ekzekutueshme, pasi njihen nga Gjykata e Apelit, bazuar në Konventën e New York *“Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”* datë 7 qershor 1959, ku RSH është aderuese.

Vendime të njohura nga Gjykata e Apelit, në proces njohje, ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, si dhe të pezulluara nga arbitrazhi ndërkombëtar për shkaqe të ndryshme.

Për vitin 2023, nga Gjykata e Apelit Tiranë është marrë vetëm 1 (një) vendim njohje Nr.131, datë 03.05.2023 për çështjen “ICC 20564/EMT/GR/H. srl kundër RSH”, (*fituar nga RSH*), vendim i cili ndodhet në procedura ekzekutimi (*MIE ka vënë në dijeni ASH për vendimin Nr.131, datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit, me shkresën Nr.3366/1, datë 18.7.2023*).

-1 vendim arbitrazhi i njohur nga Gjykata e Apelit me vendimin nr.49, datë 04.05.2021 për çështjen “ICC Case 22676/GR G.kundër MIE, AKBN & Albpetrol” (*humbur nga RSH*), është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga ASH (*shkresa Nr. 2435/2, datë 07.07.2021*).

-2 vendime arbitrazhi janë në proces njohje nga Gjykata e Apelit Tiranë:

-çështja “ICC22919/GR H. srl kundër RSH”, (fituar nga RSH), është dërguar për njohje me kërkesë nga pala shqiptare/MIE (autorizuar ASH me autorizimin Nr.5259, datë 16.10.2023 për përfaqësimin në Gjykatën e Apelit për njohje dhe dhënie fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit),

-çështja “ICSID Case ARB/15/28 datë 24.04.2019 H. srl, etj.”,(humbur nga RSH), është dërguar për njohje nga paditësi në Gjykatën e Apelit, e cila me vendimin nr.630, datë 04.03.2020 ka rrëzuar kërkesën për njohje. Paditësi ka vijuar me regjistrimin në Gjykatën e Apelit, të kërkesës për njohje të vendimit, me nr. Akti 218 dhe datë 23.11.2020. Nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka ndonjë njoftim për fillimin e procesit lidhur me njohjen e vendimit të arbitrazhit. (trajtuar më hollësisht në vijim në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga vendimi).

-2 çështje “X. K. v.s Republic of Albania” (ICSID Case No. CONC/16/1) e regjistruar më 16 Maj, 2016 dhe “ICSID Case no. ARB/20/54 A. E. v.s. RSH” janë me status të ndërprerë në ICSID.

-2 çështje “UNCITRAL Case PCA Case No. 2023-43 P. P. SHA/K. I. Ltd v.s. Albpetrol SHA(Vendburimi Amonicë)” dhe “U. Case P.SHA/K. I. Ltd v.s. Albpetrol SHA (Vendburimet Panaja, Frakull, Povelca, Divjaka, Ballaj-Kryevidh)” kanë përfunduar për shkak të tërheqjes nga procesi i arbitrazhit të palës paditëse.

Shënim: Për çështjen “U. Case PCA Case No. 2023-43 P. P. SHA/K. I. Ltd v.s. Albpetrol SHA (Vendburimi Amonicë)”, arbitrazhi është shprehur për përfundim të procedurës pa paragjykim (pa cënuar të drejtat ose pretendimet e ardhshme të palëve), si dhe detyrimin e paditësit të paguaj shpenzimet e arbitrazhit, duke patur kështu një urdhër gjykate për vendimarrje për kostot deri në atë moment, ndërsa Albpetrol nuk ka asnjë detyrim.

Referuar Regjistrin, çështje arbitrazhi të iniciuara ndaj Republikës së Shqipërisë si dhe vendime arbitrazhi deri në 31.12.2023 janë 18.

Tabela 1. Çështje arbitrazhi të iniciuara ndaj Republikës së Shqipërisë si dhe vendime arbitrazhi deri në 31.12.2023.

Nr.	Iniciuar	Çështja	Palët	Totali detyrimeve të pretenduara për çështje të iniciuara/Detyrime nga vendimi final i arbitrazhit
1	2014	ICSID ARB/14/26	“A.A.” SHPK etj. kundër RSH/MTM	Detyrim i pretenduar nga iniciimi arbitrazhit: -297,000,000 Euro si dëm për imazhin, dhe zbatimin e Kontratës, ose ne menyre alternative €452,600,000 si dëmshpërblim. -Detyrime nga vendimi final i Arbitrazhit 03.03.2020 për paditësin ndaj RSH në total: -837,125.71 USD, -2,407,000 Euro -106,755 GBP+penalite që përbëhen: Detyrime nga vendimi i Arbitrazhit: -427,488.72 USD–kosto dhe shpenzime të Tribunalit gjyqësore -1,857,000Euro–shpenzime gjyqësore -106,755 GBP –shpenzime administ. Detyrime nga vendimi i Anullimit 06.05.2022: -409,636.99 USD shpenzimet e Tribunalit -550,000 Euro kostot e përfaqësimit dhe shpenzimet e RSH. Penalite: Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot.
2	2018	ICCCase23998/MHM(C-24011/MHM)	BOE “JV C. C. E.&A.T.” kundër RSH (MPPT/ARRSH)	Detyrime të RSH në total nga vendimi i Arbitrazhit: -44,262,681.41USD -573,081.13 Euro që përbëhen: -USD 30,264,019.64; -USD 13,998,662.77; -261,556.75 Euro - kosto adm. të paditësit; -161,524.38 Euro - rimbursim të kostove ligjore të paditësit. Detyrime të RSH nga vendimi i Anullimit 31.05.2022: -150,000 Euro shpenzime gjyqësore paditësit.
3	2018	ICCCase 24140/MHM	Shoqëria C. D. s.p.a, kundër RSH (MIE, AKUK)	Detyrim i pretenduar nga iniciimi çështjes: rreth 35,000,000 Euro RSH me kundërpadi dhe minimumi që paditësi i detyrohet RSH kuantifikuar në vlerë rreth 36,413,664.45 Euro.

				Ne proces deri në 31 dhjetor 2023
4	2015	ICSID ARB/15/28	H. srl, C. etj. kundër RSH/MFE	Detyrimi në total i RSH nga vendimi final i Arbitrazhit 24.04.2019 është 107,709,238.5 Euro, 2,346,442.13 USD që përbëhen: -99,487,000 Euro demshperblim + -8,222,238.53 Euro – shpenzime ligjore paditesit + -645.183,42 USD kosto arbitrazhi + interesa Libor+3% tremujor prej 31.03.2018 Detyrime të RSH nga <u>Procesi i Anullimit</u> 29.03.2023: 1,701,258.71 USD + interes LIBOR(ose SOFR nëse LIBOR nuk ekziston më derisa të bëhet pagesa e plotë)+ 3% tremujor nga data 31 mars 2021.
5	2014	ICCCase20564/ EMT/GR	H. S.R.L. kundër RSH/ MIE	Detyrim i RSH nga <u>vendimi i arbitrazhit</u> 07.09.2018: -t'i rimburojë 142,975.78 Euro Hydro-s, lidhur me kostot e Fazës II të arbitrazhit <u>Detyrim i Paditesit</u> për t'i paguar RSH si penalitet për vonesat në zhvillimin e kontratës 1,693,157 Euro + interesa te përbëra me bazë 12-mujore Euro Libor +2% nga data 9.1.2018 deri ne pagesën e plotë; - <u>Detyrim i H.</u> që t'i rimburojë RSH me 325,000 USD kosto ligjore dhe të arbitrazhit.
6	2017	ICC Case 22919/GR	H.S.R.L kundër RSH/MIE	Detyrimi i H. nga <u>vendimi final i arbitrazhit</u> 04.06.2019: t'i paguajë RSH 731,280 Euro + 1795.60 GBP kosto ligjore dhe arbitrazhi. Detyrimi i H. ndaj RSH nga <u>procesi i anulimit</u> 31.05.2022: të paguajë 60.000 Euro shpenzime ligjore
7	2015	ICC Case 21349/GR	B. P. A. ltd kundër MIE, AKBN Albpetrol	Nuk ka detyrime potenciale (mosmarrëveshje) mbi (mos)njohtjen e kostove të rrjedhura nga auditit në 2011 dhe draft auditet 2012-2017.Ne proces deri 31.12. 2023
8	2018	PCA Case 2018-49	V. I s.r.l. kundër RSH/MBZHR	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi 69,000,000 Euro Në proces
9	2016	ICSIDCase CONC/16/1	X. K. kundër RSH	<u>Detyrime të kërkuara</u> nga paditësi: 424,254,818 USD Ka ofruar pajtim per 10% te vleres se pretenduar. Arbitrazhi nuk ka filluar ende.Pezulluar që në vitin 2016 për shkak të procedurës së pajtimit.
10	2020	ICSID Case no.ARB/20/37	M. C. Trade Corp, A.D.LP, Durrës K. Sh. SH.A. Durrës C.T. kundër RSH (MIE/APD)	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi në iniciim të arbitrazhit: 100,000,000 Euro dhe më pas është kuantifikuar nga paditësi në vlerën 63,700,000 Euro. Në proces.
11	2020	ICSIDCase ARB/20/54	Arka Energy B.V kundër RSH (MIE)	Procesi është ndërprerë (Discontinued) për shkak se palët nuk kanë paguar shpenzimet administrative fillestare të Tribunalit.
12	2021	SCC Arbitration 2021/155	I. H. GmbH kundër RSH/MFE	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi: 37,224,810 Euro . Në proces deri në dhjetor 2023
13	2021	D. Group/D. Energji v MIE	D. G. shpk/D. E. kundër MIE	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi: 2,788,933,741 Lekë -Vlera e kërkuar prej MIE në Kundërpadi 14,630,050,747 Lekë .
14	2017	ICCCase 22676/GR	G. O.C. LTD kundër MIE, AKBN, Albpetrol	Detyrime të MIE dhe AKBN nga <u>vendimi final i Arbitrazhit</u> 06.07.2020: -t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD – demshpërblim -t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,451.68 EURO , me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.
15	2022	M. N. v. Republic of Albania	M. N kundër RSH (MF)	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi: 123,631,425 Euro. Në proces
16	2023	ICSID Case No. ARB/23/9	E. Sh. & T. G. kundër RSH (MIE/APD)	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi:72,200,000 Euro Në proces
17	2023	UNCITRAL Case PCA Case No. 2023-43	P. P. SHA/ K. I. Ltd kundër Albpetrol SHA	<u>Detyrime të pretenduara</u> nga paditësi: 60,000,000 USD Përfunduar (Vendburimi Amonicës)
18	2023	UNCITRAL Case	P. P. SHA kundër Albpetrol ShA	Përfunduar (Vendburimet Panaja, Frakull, Povelca, Divjaka, Ballaj-Kryevidh)

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Përmbledhëse e çështjeve të arbitrazhit të iniciuara ndaj Republikës së Shqipërisë si dhe vendime arbitrazhi deri në 31.12.2023:

Tabela 2 Përmbledhëse e çështjeve të arbitrazhit të iniciuara ndaj Republikës së Shqipërisë si dhe vendime arbitrazhi deri në 31.12.2023:

Nr.	2014	2015	2016	2017	2018	2020	2021	2022	2023
1	ICSID ARB/14/26	ICSID ARB/15/28	ICSIDCase CONC/16 /1	ICC Case 22919/G.	ICCCase23998/MHM(C-24011/MHM)	ICSID Case ARB/20/37	SCC Arbitration 2021/155	M. N. v. Republic of Albania	ICSID Case ARB/23/9
2	ICCCase20 564/E./G.	ICC Case 21349/G.		ICCCase 22676/G.	ICCCase 24140/MHM	ICSID Case ARB/20/54	D.G/D. E. v MIE		U.Case PCA Case 2023-43
3					PCA Case 2018-49				U. Case

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Refruar të dhënave të sipërme të tabelës 1, rezulton se 3 çështje/vendime, janë të regjistruara në vitin 2023, nga të cilat 2 janë vendime arbitrazhi që rezultojnë me status të përfunduar dhe 1 është çështje e regjistruar për inicim arbitrazhi konkretisht:

1. “P. P. SHA” kundër “Albepetrol SHA”, (vendburimi Amonicë), me status të përfunduar, vlera e pretenduar prej palës kërkuese 60,000,000 USD bazuar në Vendimin e përfundimit të procedurave dhe Vendimit mbi Kostot e Arbitrazhit datë 11.12.2023 sipas të cilit:

-Procedura përfundohet pa paragjykim (terminated without prejudice – pa cenuar të drejtat ose pretendimet e ardhshme të Palëve).

-Paditësi, urdhërohet të paguajë shpenzimet e këtij arbitrazhi, siç përcaktohet në Nenin 40 të Rregullave të UNCITRAL-it. Në këto kushte, kemi një urdhër gjykate për vendimarrje për kostot deri në atë moment, ndërsa Albpetrol nuk ka asnjë detyrim.

2. “P. P. SHA/K. I. Ltd” kundër “Albepetrol SHA”, (Vendburimet Panaja, Frakull, Povelca, Divjaka, Ballaj-Kryevidh) me status të **përfunduar**, vlera e pretendimit fillestar të palës kërkuese 60 000 000 USD për 5 vendburimet. Çështja është përfunduar për shkak të tërheqjes nga procesi i arbitrazhit të Palës Paditëse.

1. Çështja “E. S. &T.G” palë paditëse dhe e paditur RSH (MIE/APD), regjistruar me datë 03.07.2023 iniciimi për arbitrazh, me detyrim potencial të pretenduar 40,000,000 euro.

Për sa sipër (Çështja “E. Sh. &T. G”), nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.6, datë 06.09.2024, nga Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.M. I., me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi subjektit: “Dëshirojmë të shtojmë se vlera e pretenduar nga paditësi fillimisht u paraqit 40,000,000 Euro, duke u kuantifikuar më pas nga pala paditëse në vlerën 72,200,000 Euro”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Saktësimi i kësaj vlere (të dhëne) nga ana e Avokaturës së Shtetit merret në konsideratë dhe u reflektua në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në të dhënat e tabelës 1, nr. 16, më sipër si dhe më poshtë ku trajtohet kjo çështje.

ASH gjithashtu është njoftuar për përfundimin e 3 çështjeve në arbitrazh në periudhën e ushtrimit të auditimit, për të cilat janë marrë vendimet respektive finale të arbitrazhit në 2024, të dhënat e të cilave janë pasqyruar më sipër në tabelën 1, konkretisht:

1. Çështja ICSID Case ARB/20/37 kundër RSH (MIE/APD), ku paditësi kishte kërkuar kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj operacioneve të shoqërisë D. C.T., pretenduar në vlerën rreth 100,000,000 Euro. Me datë 26 Korrik 2024, ICSID njoftoi vendimin final të

arbitrazhit i cili detyron paditësin të mbulojë 70% të kostove të të paditurit (RSH) si dhe t'i paguaj atij 370,542.55 USD dhe 1,583,512 Euro.

2. Çështja SCC Arbitration 2021/155 I. H. G. kundër RSH/MFE, ku paditësi kishte kërkuar kompensimin e dëmit në vlerën 37,224,810.82 Euro. Me datë 26 Qershor 2024, vendimi final i arbitrazhit ka rrëzuar pretendimet e paditësit.

3. Çështja “E. S. & Trading GmbH” palë paditëse dhe e paditur **RSH (MIE/APD)**, regjistruar me datë 03.07.2023 iniciimi për arbitrazh, me detyrim potencial të pretenduar 72,200,000 euro. Me datë 13 Korrik 2024 është dërguar urdhëri për ndërprerjen e procedurës në përputhje me Rregullin e Arbitrazhit ICSID 55(2).

Vendimet finale të arbitrazhit në favor të RSH, kanë ndikim në uljen e vlerës së detyrimeve që ka RSH ndaj palëve të treta.

Procedurat e ndjekura për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit deri në 31.12.2023.

Në zbatim të nenit 18, pika 1.2, germa “x”, të Rregullores së brendshme “Në rastet kur palë paditëse ose e paditur është Republika e Shqipërisë, Avokatura e Shtetit, me komunikimin e çështjes së arbitrazhit, identifikon institucion/in/et përgjegjës ...”. ASH/Zyra përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, pas përcaktimit të institucionit/organit përgjegjës që në kuptim të nenit 9, pika 5/1, të Rregullores së brendshme ku palë është Republika e Shqipërisë, konsiderohet “*ministra përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja*”, ka njoftuar me shkresat përkatëse këto organe duke i vënë në dispozicion vendimin e certifikuar dhe apostiluar të arbitrazhit me qëllim fillimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve.

Vendime arbitrazhi të formës së prerë për të cilat Avokatura e Shtetit është vënë në dijeni dhe që në zbatim të Kodit të Procedurës Civile (KPrC), neni 393, për të marrë fuqi juridike janë në proces njohje/njohur nga Gjykata e Apelit janë 6, ku për 3 çështje, vendimi arbitrazhit është shprehur në favor të RSH dhe për 3 të tjera është shprehur për detyrimet që ka RSH ndaj paditësve. (më hollësisht të dhënat sipas tabelës 3).

Tabela 3. Vendime arbitrazhi deri në datë 31.12.2023 në proces njohje/njohur nga Gjykata e Apelit

Nr.	Statusi çështjes	Iniciuar/Vendim arbitrazhi	Çështja	Njohur/në proces nga Gjykata e Apelit	Pala interesit	Detyrimi nga vendimi arbitrazhit	Statusi i vendimit
1	Fituar	2014 Vendimi 07.09.2018	ICC Case 20564/EM/GR H.srl k. RSH.	Vendimi Nr.131, datë 03.05.2023	RSH/MIE	Detyrimi i H. srl në total 6,875,692 Euro +325,000 USD që përbëhen: dëshmipërblim RSH-së: -5,182,535 Euro + interes; -penalite RSH-së për vonesa: 1,693,157 Euro me interes; -rimbursim i RSH-së, 325,000 USD Detyrimi RSH ndaj paditësit 142,975.78 Euro.	Pa ekzekutuar
2	Fituar	2017/ Vendimi 04.06.2019	ICC Case no.22919/GR H. srl k. RSH	Në proces njohje (MIE ka autorizuar ASH me autorizimin Nr.5259, datë 16.10.2023 për	RSH/MIE	Detyrimi i H. srl në total 791,280 Euro+1795.60 GBP që përbëhen:	Pa ekzekutuar

		Vendimi i anulimit 31.05.2022		<i>përfaqësimin në Gjykatën e Apelit për njohje dhe dhënie fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit).</i>		Detyrime nga vendimi arbitrazhit: 731,280 Euro + 1795.60 GBP kosto ligjore dhe të arbitrazhit. Detyrime nga procesi i anulimit: -detyrime nga vendimi i anulimit: 60.000 Euro shpenzime ligjore	
3	Fituar	2014/ Vendimi 03.03.2020 Vendimi anulimit 18.04.2022 (njoftuar palët datë 06.05.2022)	ICSID ARB/14/26 “A. A.” SHPK., etj k. RSH	Në proces njohje, (Maj 2024 është dërguar nga ICSID kopje e certifikuar e vendimit të arbitrazhit dhe apostiluar).	RSH/MTM	Detyrimi në total i paditësit ndaj RSH 837,125.71 USD, 2,407,000 Euro dhe 106,755GBP+penalitet që përbëhen: Detyrime nga vendimi i Arbitrazhit: -427,488.72 USD – kosto dhe shpenzime të Tribunalit -1,857,000 Euro – shpenzime gjyqësore 106,755 GBP – shpenzime administ. Detyrime nga vendimi i Anullimit: -409,636.99 USD shpenzimet e Tribunalit -550,000 Euro koston e përfaqësimit dhe shpenzimet e RSH. Penalite: Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen koston	Pa ekzekutuar
4	Humbur	2015/ Vendimi 24.04.2019 Vendimi i Anullimit 02.04.2021 Vendimi i Rishikimit 29.03.2023	ICSID Case ARB/15/28 datë 24.04.2019 H. etj.	Në proces njohje, (Dërguar për njohje nga paditësi në Gjykatën e Apelit, me vendimin nr.630, datë 04.03.2020, Apeli ka rrëzuar kërkesën për njohje.Paditësi ka vijuar regjistrimin në Gjykatën e Apelit, të kërkesës për njohje të vendimit me nr. 218 akti, datë 23.11.2020. Nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka ndonjë njoftim për fillimin e procesit lidhur me njohjen e vendimit të arbitrazhit).	RSH/MFE	Detyrimi në total i RSH 107,709,238.5 Euro, 2,346,442.13 USD që përbëhen: Detyrime të RSH nga vendimi i Arbitrazhit: - demshperblim 99,487,000 Euro, -8,222,238.53 Euro – shpenzime ligjore paditesit -645.183,42 UDS kosto arbitrazhi +interesa Libor Detyrime nga vendimi i Anullimit: - detyrim i RSH te paguaje koston e procedurave 1,701,258.71 USD + interes LIBOR	Pa ekzekutuar
5	Humbur	2017/ Vendimi 06.07.2020	ICC Case 22676/GR G. k. MIE/AKBN&Albpetrol	Në proces njohje (Vendimi nr.49, datë 04.05.2021 të Gjykatës së Apelit ASH ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (shkresa 2435/2, datë 0.07.2021	RSH/MIE, AKBN& Albpetrol	Detyrimi në total RSH 12,870,612.1USD dhe 14,451.68 Euro që përbëhen: Detyrime të MIE/AKBN nga vendimi i Arbitrazhit: - dëmshpërblim 12,577,852.1 USD -292,760 USD dhe 14,451.68 EURO, kosto administrative me	Pa ekzekutuar

						interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.	
6	Humbur	2018/vendimi datë 01.09.2020, (njoftuar 8 shtator) vendimi anulimit datë 31.05.2022	ICC Case 23998/MHM (C-24011/MHM)	Nuk ka informacion nëse paditësi ka kërkuar njohjen e vendimit.	RSH/MPPT /ARRSH	<p>Detyrimi në total RSH 44,262,682.41 USD dhe 573,081.13 Euro që përbëhen:</p> <p><u>Detyrime të RSH nga vendimi i Arbitrazhit:</u> -USD 30,264,019.64; -USD 13,998,662.77; -261,556.75 Euro - kosto adm. të paditësit; -161,524.38 Euro - rimbursim të kostove ligjore të paditësit.</p> <p><u>Detyrime të RSH nga vendimi i Anullimit:</u> -150,000Euro shpenzime gjyqësore paditësit</p>	Pa ekzekutuar

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Referuar të dhënave të tabelës 3, në 3 raste detyrimi i paditësve ndaj RSH është:

1.Çështja EMT/GR H.v.s. RSH-ICC Case 20564, detyrimi i shoqërisë “H”, në total është **6,875,692 Euro dhe 325,000 USD**, i cili përbëhet nga:

- dëmshpërblim RSH-së, në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 9.01.2018 deri në pagesën e plotë;
- penalitetet për Vonesat RSH-së, në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë (*interest on a compound basis*), duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë;
- detyrim për rimbursim RSH-në, në vlerën 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.

Detyrimi i RSH-së:

-t'i rimbursojë paditësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën 142,975.78 Euro.

2.Çështja H. v.s. RSH-ICC Case 22919/GR, detyrimi i H. në total është **791,280 Euro + 1795.60 GBP**, i cili përbëhet:

- 731,280 Euro + 1795.60 GBP kosto ligjore dhe kosto të tjera të kryera në kuadër të arbitrazhit
- 60.000 Euro shpenzime ligjore që rrjedhin nga vendimi i anulimit.

3.Çështja A. A. SHPK, etj. v.s. RSH-ICSID ARB/14/26, detyrimi në total i paditësit ndaj RSH-së është **837,125.71 USD, 2,407,000 Euro dhe 106,755 GBP**, i cili përbëhet:

- sipas Vendimit të arbitrazhit datë 03.03.202, 427,488.72 USD, 1,857,000 Euro dhe 106,755 GBP, i cili përbëhet nga:
- kosto dhe shpenzime të procesit të arbitrazhit;
- shpenzime gjyqësore (*shpenzimet për studion ligjore të kontraktuar, ekspertin*);
- shpenzime administrative
- sipas Vendimit të Anullimit datë 18.04.2022 (*njoftuar palëve 6 Maj 2022*) në total është **409,636.99 USD dhe 550,000 Euro** i cili përbëhet nga:
- kostot e procedurave duke përfshirë shpenzimet e Tribunalit;
- kostot e përfaqësimit dhe shpenzimet e RSH. Kjo shumë duhet të paguhet brenda njëzet e tetë (28) ditëve nga data e dorëzimit të Vendimit. Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove

interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot;

-Penalite: Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë mujor, derisa të paguhen kostot.

Gjetja 2: Nga auditimi konstatohet se për 2 vendime (ICC Case 22919/GR dhe ICSID ARB/14/26) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që kanë paditësit ndaj RSH, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit/të paditurve (RSH/MIE, MTM) në procedurat e njohjes të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile (KPrC), neni 393 dhe 398, duke mos arkëtuar në buxhetin e shtetit vlerën **10,013,972 Euro, 1,162,125.71 USD dhe 108,550.6 GBP**, e cila përfshin: vlerën e dëmshpërblimit, penalitete për vonesa, vlera të rimbursimit, tarifa dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzime administrative të ICC si dhe kosto ligjore + interesa, pasqyruar në tabelën 4 më poshtë:

Tabela 4 Detyrimet e paditësve ndaj RSH nga vendimet e arbitrazhit 2023

Çështja	Vendime arbitrazhi 2023		
	Detyrimi në Euro	Detyrimi në USD	Detyrimi në GBP
ICC Case 20564	6,875,692	325,000	
ICC Case 22919/GR	791,280		1795.60
ICSID ARB/14/26	2,407,000	837,125.71	106,755
TOTALI	10,013,972	1,162,125.71	108,550.6

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Referuar të dhënave të tabelës 4, në 3 raste detyrimi i RSH ndaj paditësve rezulton:

1.Çështja H.-ICSID Case ARB/15/28, detyrimi në total i RSH **107,709,238.5 Euro** dhe **2,346,442.13 USD**, i cili përbëhet:

-sipas vendimit të arbitrazhit datë 24.04.2019, në total **107,709,238.5 Euro** dhe **645,183.42 UDS+** interesa mbi shumat e paragrafëve (3) deri në (8) të dispozitivit të vendimit Libor+3% tremujor prej 31.03.2018 deri në pagesën e plotë, i përbërë nga:

-dëmshpërblim ndaj M. R. në shumën 46,751,000 Euro për shpronësimin e interesit të tij në Agonset;

-dëmshpërblim ndaj S. G. në shumën 11,688,000 Euro për shpronësimin e interesit të saj në Agonset;

-dëmshpërblim ndaj F. B. në shumën 41,048,000 Euro për shpronësimin e interesit të tij në Agonset;

- 75 % të kostove ligjore, ekspertëve dhe kostot e lidhura me të në shumën 8,222,238.53 Euro;

- 100 % të kostove të arbitrazhit të Paditësve në shumën 645,183.42 UDS + interesa mbi shumat e paragrafëve (3) deri në (8) të dispozitivit të vendimit Libor+3% tremujor prej 31.03.2018 deri në pagesën e plotë;

Detyrime nga Procesi i Anullimit, sipas vendimit të anullimit datë 02.04.2021 në total është **1,701,258.71 USD + interes** nga:

-të paguaj të gjitha kostot e procedurave duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e anëtarëve të Tribunalit, kostot administrative dhe shpenzimet direkte si dhe kostot ligjore të Paditësve në shumën e 1,701,258.71 USD + interes LIBOR (ose SOFR nëse LIBOR nuk ekziston më derisa të bëhet pagesa e plotë) + 3% tremujor nga data 31 mars 2021.

2.Çështja ICC Case 22676/GR G. v. MIE, AKBN & Albpetrol, sipas vendimit të arbitrazhit datë 06.07.2020, në total detyrimi i RSH (MIE/AKBN) ndaj paditësit është **12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+ interesa**, i cili përbëhet nga:

- vlera 12,577,852.1 USD, si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencë Marreveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit;
- 40 % të kostove administrative;
- 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

3.Çështja ICC Case 23998/MHM(C-24011/MHM), në total detyrimi i RSH (ARRSH/MIE) ndaj paditësit **44, 262,682. 41 USD** dhe **573,081.13 Euro**, i cili përbëhet:

- sipas vendimit të arbitrazhit datë 01.09.2020, detyrimi në total **44,262,682.41 USD** dhe **423,081.13 Euro** rimbursim të kostove ligjore të paditësit dhe kosto administrative
- sipas vendimit të anulimit datë 31.05.2022 në total **150,000 Euro** shpenzime gjyqësore.

Gjithashtu për çështjen **E/G. H. v.s. RSH-ICC Case 20564**, e cila është fituar nga RSH dhe është trajtuar në vendimet që sjellin detyrime për palët paditëse ka dhe një detyrim të RSH-së, t'i rimbursojë paditësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën **142,975.78 Euro**.

Gjetja 3: Nga auditimi konstatohet se për vendimet e arbitrazhit (*ICSID Case ARB/15/28, ICC Case 22676/GR GBC, ICC Case 23998/MHM dhe ICC Case 20564*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet e RSH ndaj paditësve, ka vonesa në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit në zbatim të nenit 398 K.Pr.Civile, nga mosveprimi në kohë i paditësave, që ka sjellë si pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH në vlerën **108,439,747.08 Euro** dhe **59,479,735.64 USD** e cila përfshin: vlerën e dëmshpërblimit, penaltete për vonesa, vlera të rimbursimit, tarifa dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzime administrative të ICC si dhe kosto ligjore + interesa, shprehur në tabelën 5 më poshtë:

Tabela 5 Detyrimi i RSH-së nga vendimet e arbitrazhit 2023

Çështja	Vendime arbitrazhi 2023	
	Detyrimi në Euro	Detyrimi në USD
ICSID Case ARB/15/28	107,709,238.5	2,346,442.13
ICC Case 22676/GR	14,451.68	12,870,612.1
ICC Case 23998/MHM (C24011/MHM)	573,081.13	44, 262,682. 41
ICC Case 20564	142,975.78	
TOTALI	108,439,747.08	59,479,736.64

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Institucionet e interesuara (ministritë dhe agjencitë përkatëse) që janë njohur me vendimet e Gjykatës së Apelit, procedurat e ndjekura nga këto palë për njohjen e vendimit të arbitrazhit dhe statusi aktual mbi ekzekutimin e vendimeve.

MIE:

-Për çështjen “ICC 20564/E/G.E./H. kundër RSH”, (*fituar nga RSH*), me shkresën Nr.1215/1, datë 06.04.2023 ASH ka vënë në dispozicion të MIE vendimin e arbitrazhit të certifikuar nga ICC të formës së prerë dhe të pajisur me vulë apostile. MIE me shkresën Nr.3366/1, datë 18.07.2023 ka njoftuar ASH, për njohjen dhe dhënien fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit Nr.131, datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

-Për çështjen “ICC22919/G. H. kundër RSH”, (*fituar nga RSH*), me shkresën Nr. 1215/1, datë 06.04.2023 ASH ka vënë në dispozicion të MIE vendimin e arbitrazhit të certifikuar nga ICC

të formës së prerë dhe të pajisur me vulë apostile. Çështja është në proces shqyrtimi nga Gjykata e Apelit.

-Për çështjen “ICSID Case ARB/15/28 datë 24.04.2019 H., etj.”(*humbur nga RSH*), ASH ka njoftuar MIE me shkresën Nr.1826/2, datë 06.08.2019 mbi vendimin e arbitrazhit. Pala paditëse ka dërguar për njohje vendimin e arbitrazhit në Gjykatën e Apelit Tiranë, me nr.Akti 218, datë 23.11.2020. Nga Gjykata e Apelit nuk ka njoftim mbi fillimin e procesit të njohjes së vendimit të arbitrazhit (nuk ka filluar shqyrtimi i saj).

-Për çështjen “ICC 22676/GR G. O. kundër MIE, AKBN & Albpetrol datë 06.07.2020, (*humbur nga RSH*), ASH me shkresën Nr.1526/3, datë 29.07.2020 ka vënë në dispozicion të MIE dhe AKBN vendimin e arbitrazhit. Paditësi ka bërë kërkesë për njohje të vendimit të arbitrazhit, njohur nga Gjykata e Apelit me vendimin Nr.49, datë 04.05.2021. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, nga ASH është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (shkresa 2435/2, datë 0.07.2021) ku është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit, pushimi i gjykimit dhe pezullimi i ekezekutimit, i cili nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë, ndërsa për kërkimet e tjera nuk ka një datë të planifikuar.

ARRSH-MIE:

-Për çështjen “ICC23998/MHM(C-24011/MHM)”, me shkresën Nr.119/1, datë 20.01.2023 ASH ka kthyer pergjigje ARRSH dhe për dijeni MIE-s mbi propozimin e bërë nga paditësi për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes që lidhen me vendimin e arbitrazhit, nuk ka informacion nëse ka filluar paditësi njohjen e vendimit të Arbitrazhit në Gjykatën e Apelit në RSH.

MTM:

- Çështja “ICSID ARB/14/26, fituar në arbitrazh në favor të RSH. ASH me shkresën nr.6067, datë 21.11.2023, ka rikujtuar MTM, si institucion interesuar për njohjen dhe kryerjen e procedurave për dhënie fuqi juridike vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit vendas, ndërkohë që, ASH ka vijuar me procedurat për zyrtarizimin dhe certifikimin e vendimit të arbitrazhit duke ju drejtuar ICSID, procedurë që ka vazhduar deri në qershor 2024. Në 2024 është dërguar vendimi zyrtar nga ICSID dhe është bërë apostulimi i saj në ambasadën e RSH në Washington.

Raportimi mbi vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar në zbatim të Udhëzimit plotësues të MFE Nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.

Referuar UMF Nr.9 datë 20.03.2018”*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”* dhe Nr.2, datë 19.01.2023, pika 126.5, germa ”c”, Avokatura e Shtetit, brenda datës 10 Maj dhe 10 Shtator të çdo viti buxhetor, si dhe sa herë kërkohet nga MFE, raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, në rrugë zyrtare shkresore dhe elektronike për sa vijon:Avokatura e Shtetit dërgon regjistrin e përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queue).

Në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi ligjor për vitin 2023, nga ASH me e-mail datë 16.06.2023, si dhe me e-mail datë 12.09.2023 dhe shkresën Nr. 4831/1, datë 30.10.2023 është dërguar në MFE, informacioni mbi detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.6, datë 06.09.2024, nga Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe

Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.M. I., me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi subjektit: " Në fq 11, të dokumentit Akt Konstatim Nr.6, lidhur me raportimin në Ministrinë e Financave evidentohet si vijon: ...nga ASH është tejkaluar afati si dhe nuk është respektuar forma e kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit...Raportimi i Avokaturës së Shtetit drejtuar Ministrisë së Financave është kryer brenda afatit të përcaktuar me e mail zyrtar. Ndërsa përcjellja me shkresë...ka kaluar ciklin e brendshëm të firmosjes...Gjithashtu sa i përket formës së kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit nuk kemi pasur kontestime nga Ministria e Financave... ”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Pretendimi i subjektit **merret** në konsideratë, për atë kohë sa raportimi nuk ka sjellë pengesa në hartimin e rakordimin e të dhënave me Ministrinë e Financave, por konstatimi i KLSH duhet mbajtur në konsideratë nga subjekti, për përmbushjen e detyrimit ligjor që buron nga UMF Nr.2, datë 19.01.2023 nga ku mos respektimi, mund të çojë në pasojë për mos rakordimin në kohë të të dhënave”. Ndryshimet u pasqyruan në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Gjetja 4: Nga krahasimi i të dhënave të dërguara nga Avokatura e Shtetit në Ministrinë e Financave (MF) me shkresën Nr.17/1, datë 19.04.2024, për detyrimet nga vendime të arbitrazhit me të dhënat e administruara nga ASH deri me 31.12.2023 si dhe ato të publikuara si pjesë e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023 (*këtu e më poshtë Raporti*) “*Detyrime të tjera kontigjente*” rezulton:

Raportimi nga Avokatura e Shtetit është bërë në mënyrë periodike 2 herë në vit buxhetor (brenda datës 10 Maj dhe 10 Shtator), ndërsa të dhënat e publikuara nga MF në Raport, përfshijnë detyrimet deri në Prill 2024 dhe jo detyrimet deri në 31.12.2023. Referuar shkresës Nr. 1795/1 datë19.04.2024 nga ASH raportohen për Ministrinë e Financave në kuadër të përgatitjes së dokumentit të “Deklaratës së Risqeve Fiskale për vitin 2023”, detyrimet e përfshira deri në datën e raportimit (prill 2024) dhe jo deri në datën 31 Dhjetor 2023, megjithëse nga MF janë kërkuar të dhëna deri në këtë datë. Për rrjedhojë, konstatohet pasaktësi në vlerën e detyrimit që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse në vlerën 13,492,241 Euro.

Detyrimi i RSH (dëmshpërblimi) që rrjedh nga vendimet e Arbitrazhit deri në datën 31 Dhjetor 2023, në total, duhet të ishte 169,759,855 Euro (183,252,095-13,492,241), përfshirë kostot administrative, ligjore dhe të pa likuidara, ndërkohë që në Raportin e MF “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situaten makroekonomike dhe fiskale gjate vitit 2023”, këto detyrime në total raportohen 183,252,095 Euro (*njësuar në monedhë të vetme Euro*).

Nga ASH, të regjistruara detyrimet e Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga vendime finale (përfundimtare) deri 31.12.2023 (*pa kostot administrative dhe ligjore*) janë në vlerën 108,439,747.12 Euro dhe 59,479,736.64 USD, ndërsa në Raportin e MF shprehen në monedhë Euro.

Më konkretisht nga krahasimi i të dhënave të raportuara nga ASH dhe atyre të publikuara në Raportin e MF:

-për çështjen ICC Case 24140/MHM, në Raport në kolonën “*detyrimi i faturuar*” që nënkupton detyrimin nga vendimi final i arbitrazhit, rezulton vlera 13,492,241 Euro, ndërkohë që deri në 31.12.2023 në të dhënat e ASH kemi vetëm detyrim të pretenduar (*rrëth 35,000,000 Euro, si dhe RSH me kundërpadi dhe minimumi që paditësi i detyrohet RSH, kuantifikuar në vlerë rrëth 36,413,664.45 Euro*) pasi nuk ka një vendim final arbitrazhi, Vendimi ka dalë me 14.03.2024. Detyrimi që rrjedh nga vendimi në vlerën 13,492,241 Euro është raportuar nga ASH në Prill 2024.

Nga ASH janë raportuar në Prill 2024 shpenzime përfaqësimi dhe gjyqësore 1,101,647 Euro, shpenzime ekspertimi dhe administrative 785,700 USD si dhe 7612.5 GBP shpenzime gjyqësore, ndërsa në Raportin e publikuar nga MF raportohen kosto administrative të

përfaqësimit dhe kosto ligjore 28,500 Euro të pa likujduara. Në lidhje me likujdimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje AKUK, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.

-për çështjen ICC Case 23998/MHM në Raportin Vjetor në kolonën “*detyrimi i faturuar*” rezulton vlera 42,472,629 Euro, ndërkohë në të dhënat e administruara nga ASH deri në 31.12.2023 si dhe ato të raportuara në Prill 2024, kjo vlerë është 44,264,681.41 USD dhe 573,081.13 Euro. Në lidhje me kostot ligjore dhe administrative për këtë çështje nga ASH nuk rezulton të jetë raportuar për to, me arsyetimin se nuk kanë ardhur fatura të tjera për likujdim duke e quajtur detyrim të mbyllur, ndërkohë në Raportin e MF këto detyrime rezultojnë në vlerën 225,000 Euro të pa likuiduar akoma. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje/ARRSH, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.

-për çështjen ICSID ARB/15/28, në Raport në kolonën “*detyrimi i faturuar*” nuk është vendosur asnjë vlerë mbi detyrimet që rrjedhin nga vendimi final i arbitrazhit i cili është në proces njohje në Gjykatën e Apelit për të marrë fuqi juridike që në vitin 2020, ndërkohë nga ASH është raportuar në Prill 2024, dhe jo me 31.12.2023, detyrimi që rrjedh nga vendimi final i arbitrazhit duke u shprehur “rreth 108,000,000 Euro”, pra jo me saktësi në një vlerë prej 290,764.5 Euro, pasi vendimi i arbitrazhit shprehet për vlerën 107,709,238.5 Euro, 2,346,442.13 USD (*dëmshpërblim dhe kosto administrative e ligjore*).

Gjithashtu nga ASH janë raportuar në MF, kosto përfaqësimi për kundërshtimin e ekzekutimit të arbitrazhit në total 2.176,404 Euro dhe 700,000 GBP, si dhe kosto përfaqësimi për procedurat e rishikimit të vendimit të arbitrazhit në vlerën 950,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF rezulton vlera 1,698,417 Euro e pa likujduar si kosto ligjore.

-për çështjen ICC Case 22919/GR, ASH nuk ka raportuar kosto administrative dhe ligjore, ndërkohë në Raportin e MF publikohen 111,150 Euro të pa likuiduar. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje/MIE, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.

-për çështjen ICSID ARB/20/37, ASH ka raportuar kosto ekspertimi 360,000 Euro, ndërsa në Raportin e MFE publikohen 690,000 Euro të pa likujduar (kosto administrative dhe ligjore)

Në lidhje me likujdimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje APD, ASH nuk ka informacion nga ky institucion.

-për çështjen ICCD 22676/GR, ASH ka raportuar detyrimin nga vendimi final i arbitrazhit që ka Republika e Shqipërisë në total në vlerën 12,870,612.1 USD dhe 14,451.68 Euro, ndërsa MF raporton 12,241,533 Euro.

- për çështjen ICC 21349/GR, ASH ka raportuar kosto përfaqësimi 175,000,000 Euro dhe 880,000 USD, ndërkohë në Raportin e MF, pasqyruar kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit në vlerën 390,764 Euro të pa likuiduara. Në lidhje me likujdimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje MIE/AKBN,/Albpetrol, ASH nuk ka informacion nga këto institucione.

- për çështjen SCC 2021/155, ASH ka raportuar kosto ekspertimi 610,028 Euro, shpenzime gjyqësore 2630.35 Euro dhe 1300.09 GBP, si dhe kosto përfaqësimi 1,650,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF, kosto paraprake dhe ligjore pasqyruar në vlerën 973,886 Euro si detyrime të pa likuiduara. Nuk ka informacion nga MF si palë në proces.

-për çështjen M.N. kundër RSH, ASH raporton kosto përfaqësimi 675,000 Euro dhe shpenzime gjyqësore 100,000 Euro, ndërsa në Raportin e MF raportohen 645,000 Euro kosto përfaqësimi të palikujduara. Nuk ka informacion nga MF si palë në proces.

-për çështjen PCA Case 2028-49, ASH ka raportuar kosto përfaqësimi 750,000 Euro, ndërsa në Raportin MF rezulton 200,000 Euro kosto administrative dhe ligjore të pa likujduara.

Avokatura e Shtetit në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit për kostot administrative dhe ligjore, dërgon menjëherë në ministrinë përkatëse që janë palë në proces faturat për likujdim. Nga momenti që faturat janë konfirmuar nga dërguesi që janë likujduar,

ASH nuk raporton më për këto detyrime, ndërkohë që subjektet palë në proces duhet të rakordojnë për ecurinë e detyrimeve të mbetura apo të likujduara prej tyre.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.6, datë 06.09.2024, nga Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.M. I., me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024, si dhe me shkresën Nr. 3316/6, datë 01.11.2024, protokolluar në KLSH me shkresënNr. 853/11, datë 04.11.2024 në lidhje me Projektraportin e auditimit nga grupi i punës znj. M. I. dhe E. D., Avokat Shteti.

Pretendimi subjektiv:

1. "Në lidhje me rekomandimet për marrjen e masave për Rekomandimin 4.1 sqarojmë se Avokatura e Shtetit në zbatim të UMF Nr.9, datë 20.03.2021 dhe Nr.2, datë 19.01.2023 raporton në MF detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit sipas formatit të kërkuar nga MF...".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me këtë argument të subjektivit sqarojmë se, rekomandimi i KLSH-së shpreh raportin e bashkëpunimit që duhet të ketë Avokatura e Shtetit me MF dhe ministrinë palë në proces arbitrazhi, në zbatim të UMF Nr.9, datë 20.03.2021 dhe Nr.2, datë 19.01.2023, me qëllim që të dhënat e raportuara t'i përkasin periudhës buxhetore për të cilën raportohet dhe në formën që kërkohet.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi mbi ecurinë e detyrimeve për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 deri 31.12.2023) rezultoi:

☞ Regjistri i posaçëm fizik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të arbitrazhit ndërkombëtar, nuk rezulton i plotësuar në të gjitha rubrikat e formatit të miratuar, pasi nuk përmban të dhëna mbi datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes/vendimit për arbitrazh në protokoll, për çështje të inicijuara para vitit 2022 (kohë në të cilën ka dalë urdhëri për miratimin e formatit të Regjistrimit) jo në përputhje me kërkesën e nenit 17 pika 3, germa "c" dhe nenit 18, pika 1.2, germa "r" të Rregullores dhe formatit të Regjistrimit.

☞ Për 3 vendime finale arbitrazhi shprehur në favor të RSH, rezulton të ketë vonesa në ekzekutimin e tyre, nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit (RSH), që ka sjellë si pasojë mos arkëtimin në buxhetin e shtetit të vlerës 10,073,972 Euro, 1,162,125.75 USD dhe 108,550.6 GBP, e cila përfshin: vlerën e dëmshpërblimit, penaltete për vonesa, vlera të rimbursimit, tarifa dhe shpenzimeve të arbitrazhit dhe shpenzime administrative të ICC si dhe kosto ligjore + interesa.

☞ Për 4 vendime finale arbitrazhi për të cilat RSH i detyrohet palëve paditëse, ka vonesa në ekzekutimin e tyre, nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit (paditësave) për ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit në zbatim të nenit 398 K.Pr.Civile, që ka sjellë si pasojë mos ekzekutimin e vlerës 108,296,771.3 Euro dhe 59,479,735.64 USD nga RSH, si detyrim që rrjedh nga këto vendime e cila përfshin: vlerën e dëmshpërblimit, penaltete për vonesa, vlera të rimbursimit, tarifa dhe shpenzimeve të arbitrazhit dhe shpenzime administrative të ICC si dhe kosto ligjore + interesa.

☞ Nga krahasimi i të dhënave të dërguara nga Avokatura e Shtetit në Ministrinë e Financave (MF) me shkresën Nr.17/1, datë 19.04.2024, për detyrimet nga vendime të arbitrazhit me të dhënat e administruara nga ASH deri me 31.12.2023 si dhe ato të publikuara si pjesë e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023 (këtu e më poshtë Raporti) "Detyrime të tjera kontigjente" nga MF rezulton se në raportim janë përfshirë të dhënat deri në Prill 2024 dhe jo deri në 31.12.2023. Për rrjedhojë, konstatohet pasaktësi në vlerën e detyrimit që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse në vlerën 13,492,241 Euro, nga ASH.

Detyrimi i RSH që rrjedh nga vendimet e Arbitrazhit deri në datën 31 Dhjetor 2023, në total, duhet të ishte 169,759,855 Euro (183,252,095-13,492,241), përfshirë kostot administrative, ligjore dhe të pa likuidara, ndërkohë që në Raportin e MF “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023”, këto detyrime në total raportohen 183,252,095 Euro (*njësuar në monedhë të vetme Euro*).

Nga ASH, të regjistruara detyrimet (dëmshpërblimi) e Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga vendime finale (përfundimtare) deri 31.12.2023 (*pa kostot administrative dhe ligjore*) janë në vlerën 108,439,747.12 Euro dhe 59,479,736.64 USD, ndërsa në Raportin e MF shprehen vetëm në Euro.

2.1.Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi.

Në zbatim të pikës 2.1 të programit të auditimit “*Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Regjistri elektronik dhe fizik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare

-Korrespondenca e ASH me ministrinë/institucionet e tjera që janë palë në gjykim

-Çdo dokumentacion në funksion të auditimit.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;

-Rregullore e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit i ndryshuar;

-Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

-Kodi i Procedurës Civile (KPrC) RSH.

Avokatura e Shtetit ushtron aktivitetin e saj në bazë të Ligjit Nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Veprimtaria e brendshme e Avokaturës së Shtetit rregullohet nga “Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” e miratuar me Urdhrin nr.68, datë 28.03.2018 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, e ndryshuar me urdhrin nr.348 datë 06.07.2023.

Avokatura, në cilësinë e përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së është institucioni kompetent për nisjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të dhëna.

Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhet nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

Në funksion të këtij detyrimi ligjor, pranë zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, bazuar në Rregulloren e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” neni 17, pika 1.

Me urdhrin nr.375 datë 20.10.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formatit të regjistrit elektronik dhe fizik të çështjeve të arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja” ishte ngritur grupi i punës për hartimin e formateve përkatëse bazuar në nenin 9,pika 4, germa “g” dhe neni 17 i Rregullores.

Me Urdhrin nr.375/1 datë 21.10.2022 “Për miratimin e formatit të regjistrit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ” kanë miratuar regjistrin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ.

Gjetja 5:Formati i regjistrit elektronik për ekzekutimin e detyrimeve të GJEDNJ, miratuar me urdhrin nr.375/1 datë 21.10.2022 nuk është plotësuar sipas formatit të miratuar, duke mos përfshirë numrin e kërkesës.

Gjatë vitit 2023, nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) i janë komunikuar ASH 17 kërkesa/çështje, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me shkelje të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, procesi i rregullt ligjor si dhe 30 kërkesa të komunikuar nga GJEDNJ, duke u paraqitur sipas rastit komente fillestare, komente për shpërblimin e drejtë apo informacione të kërkuara nga vetë Gjykata nga ku:

-21 vendime të papranuara (përfshirë kërkesa hequr nga lista e rasteve të GJEDNJ-së) nga të cilat 5 (pesë) ka vendosur ta heqë kërkesat nga lista e rasteve bazuar në nenin 37/1 germa “a” për shkak të mosinteresimit të ankuesve.

-6 çështje janë nxjerrë nga lista bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, konkretisht:

-*K. kundër Shqipërisë*, komunikuar vendimi me nr.2686 prot., dt.22.05.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, zgjidhje me marrëveshje miqësore në masën 1,000 euro.

-*B. kundër Shqipërisë*, komunikuar vendimi me nr.2686 prot., dt.22.05.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, pranim i deklartës unilaterale për dëmshpërblim në masën 4,230 euro.

-*R. kundër Shqipërisë*, komunikuar vendimi me nr.4970/1prot., dt.03.10.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, duke akorduar 4,000 euro për dëmin jo pasuror dhe kostot e shpenzimet.

-*Zh. kundër Shqipërisë*, komunikuar vendimi me nr.1347/3prot., dt.16.10.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes. Akordon 1,200 euro për dëmin jo pasuror dhe 250 euro kostot e shpenzimet për aplikim.

-*L. Ç. kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjera*, komunikuar vendimi me nr.254/5 prot., dt.16.10.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes. Vlera totale e akorduar 7,250 euro për të gjithë kërkesit për dëmin pasuror dhe jo pasuror.

-*Ç. dhe S. shpk kundër Shqipërisë*, komunikuar vendimi me nr.521/2 prot., dt.14.12.2023, nxjerrë nga lista e çështjeve bazuar në nenin 37/1 germa c, e Konventës duke pranuar zgjidhjen e saj me deklaratë, duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes. Akordon 1,200 euro për shpërblim dëmi jo pasuror dhe 250 euro kostot e shpenzimet për aplikim.

Për çështjet e zgjidhura me pajtim të sipërcituara, nga Avokatura e Shtetit është pranuar Deklarata e ofruar nga GJEDNJ për zgjidhjen e çështjes me pajtim, bashkë me vlerat për shpërblimin e drejtë nisur nga fakti se për këto çështje tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar nga GJEDNJ, që ka gjetur shtetin shqiptar në shkelje sa i takon tejzgjatjes së procedurave gjyqësore apo ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, duke vlerësuar vlerat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 399/1 e vijues) për këto shkelje (50.000–100.000 lekë për çdo vit vonesë në ekzekutim) është vlerësuar pranimi i shumave të ofruara nga GJEDNJ.

Vlera totale e pranuar për çështjet e zgjidhura me pajtim është në masën 19,380 euro.

Procedura e ndjekur nga ASH mbi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ.

Me marrjen dijeni mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, ka përcjellë vendimet përkatëse për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë konform nenit 19/2 të Ligjit 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Për sa sipër për çështjen Z. kundër Shqipërisë, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.5, datë 06.09.2024, nga avokati i shtetit e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.E. D. me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Prendimi subjektit:” Në lidhje me sqarimin e dhënë se në nenin 19/2 pika 1 e ligjit 10018/2018 i ndryshuar, afatet janë ditë pune dhe jo kalenderike, observacioni merret në konsideratë dhe reflektohet në raportin final.

Avokatura e Shtetit, edhe pse gjykata (GJEDNJ) ka vendosur mospranimin apo nxjerrjen nga lista e çështjeve, ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë vendimin për përkthim bazuar në nenin 19/2 Ligjit 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar çështjet si më poshtë vlerësuar si praktika të mira konkretisht:

Referuar regjistrin të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ, vënë në dispozicion grupit të auditimit, 12 vendime (një kopje e vendimit origjinal dhe një kopje e përkthyer dhe e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë) janë përcjellë nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë për efekt të zbatimit të njëzuar të praktikës gjyqësore dhe 2 vendime pranë institucioneve të tjera specifike, në përputhje me nenin 19/2 pika/2 pika e Ligjit 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Lista e çështjeve të botuara në Fletoren Zyrtare për njësim praktike:

- A. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.111 dt.27.07.2023.
- H. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.86 dt.08.06.2023.
- Gj. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.168 dt.17.11.2023.
- R. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.168 dt.17.11.2023.
- P. shpk dhe K. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.168 dt.17.11.2023.
- Federata Shqiptare e mundjes dhe B. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.169 dt.20.11.2023.
- Prodhim veshje nr.2 SHA kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.168 dt.17.11.2023.
- F. B. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.168 dt.17.11.2023.
- G. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.164 dt.14.11.2023.
- S. kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.124 dt.21.08.2023.
- D. CO kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.124 dt.17.11.2023.
- L. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr.135 dt.22.02.2023.

Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të nenit 19/2 të Ligjit Nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar i ka përcjellë vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së.

Gjetja 6: Për 3 çështje si më poshtë MD nuk e ka respektuar këtë afat ligjor konkretisht:

- Prodhim veshje nr.2 SHA kundër Shqipërisë, komunikuar me nr.1710 prot., dt.26.10.2023, ku GJEDNJ ka pranuar ankesën në lidhje me të drejtën e aksesit të shoqërisë kërkuese në Gjykatën Kushtetuese dhe ka vendosur shpërblim dëmi 2,000 Euro, në lidhje me dëmin jo pasuror dhe kostot dhe shpenzimet. Avokatura ka përcjellë në MD me shkresën nr.5537/2 prot., dt.26.10.2023, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkresën nr.5537/3 prot., dt.21.10.2023.

-N. kundër Shqipërisë, komunikuar me nr. 5391/1prot., datë 23.10.2023 ku Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe i ka akorduar: 3,600 EURO në lidhje me dëmin jopasuror; 3,640 EURO në lidhje me kostot dhe shpenzimet. Avokatura e ka përcjellë në MD me shkresën nr.5391 prot., dt.19.10.2023, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkresën nr.5391/2 prot., dt.08.11.2023.

-L. C. kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjera, komunikuar me nr.254/5 prot., dt.16.10.2023 ku GJEDNJ ka vendosur të heqë kërkesën nga lista e rasteve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës, duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes dhe vlera e akorduar 7250 Euro për të gjithë kërkesit për dëmin pasuror dhe jo pasuror. Avokatura e ka përcjellë në MD me shkresën nr.254/6 prot., dt.19.10.2023, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkresën nr.254/7 prot., dt.08.11.2023.

Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat e ekzekutimit për 21 vendime të dala në vitin 2023, duke përfshirë dhe vendimin "D. kundër Shqipërisë", i cili është bërë përfundimtar në vitin 2024. Në 2 procedura të vitit 2023 (të cituara më poshtë) detyrimi i vendosur është i pa ekzekutuar, ndërsa në 4 procedura të vitit 2023 ekzekutimi është bërë jashtë afatit.

- Vendimi datë 05.10.2023 "L. C. kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjerë", i cili është bërë përfundimtar në të njëjtën datë, 05.10.2023. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi të heqë kërkesën nga lista e rasteve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës, duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes si dhe ka akorduar shpërblimin e drejtë prej 7,250 Euro për të gjithë kërkesit për dëmin pasuror dhe jo pasuror. Avokatura e Shtetit me marrjen dijeni të vendimit nga GJEDNJ, ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.254/6 prot dt.19.10.2023 për përkthimin e vendimit.

Me shkresën nr.254/7 prot., datë 08.11.2023 (shkresa e protokolluar pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe certifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, botuar në fletoren zyrtare Nr. 164 datë 14/11/2023. Në datën 21.11.2023 me shkresën nr.254/8 prot, Avokatura e Shtetit i ka përcjellë për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave vendimin. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton i pa ekzekutuar, **duke mosrespektuar afatet ligjore të përcaktuara.**

- Vendimi datë 30.11.2023, "Ç. dhe S. SHPK kundër Shqipërisë" i cili është bërë përfundimtar në të njëjtën datë, 30.11.2023. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur të heqë këtë kërkesë nga lista e rasteve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës, duke pranuar zgjidhjen me pajtim të çështjes. Gjykata akordoi akordoi 1,200 EUR për shpërblim dëmi jo pasuror dhe 250 EUR për kostot dhe shpenzimet. Avokatura e Shtetit me marrjen dijeni të vendimit nga GJEDNJ, -së ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar MD me shkresën Nr.521/3 prot dt. 14.12.2023 për përkthimin e vendimit. Me shkresën Nr.24 prot., datë 08.01.2024 (me këtë numër protokolluar pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe certifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, botuar në fletoren zyrtare Nr. 4 datë 08/01/2024. Në datën 12.01.2024, me shkresën Nr.24/1prot., Avokatura e Shtetit i ka përcjellë për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë vendimin. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton i pa ekzekutuar, **duke mosrespektuar afatet ligjore të përcaktuara.**

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.5, datë 06.09.2024, nga avokati i shtetit e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.E. D. me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi subjektiv: " Në lidhje me çështjen L. C. kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjerë" jemi informuar nga Ministria së Financave (bashkëlidhur emaili)se vendimi është ekzekutuar

me datë 01.03.2024 në shumën totale 809,509 lekë, ndërsa **“Ç. dhe S. SHPK kundër Shqipërisë”** është ekzekutuar më datë 21.02.2024 në shumën totale prej **153,700 lekë”**.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i subjektit konfirmon konstatimin e KLSH-së, në lidhje me mosrespektimin e afateve ligjore të ekzekutimit, për pasojë nuk merret në konsideratë. Ndërsa për sa i përket faktit *“të pa ekzekutuara”* merret në konsideratë referuar dokumentacionit bashkëlidhur observacionit dhe reflektohen ndryshimet në vlerën totale të pasqyruar në raportin përfundimtar.

- Vendimi datë 19.10.2023 **“Prodhim veshje nr. 2 SHA kundër Shqipërisë”** i cili është bërë përfundimtar në 19.10.2023, duke akorduar një vlerë prej 2,000 Euro nga GJEDNJ. Avokatura e Shtetit me marrjen dijëni të vendimit nga GJEDNJ, ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.5537/2 prot., dt.26.10.2023 për përkthimin e vendimit. Me shkresën nr.5537/3 prot. datë 21.11.2023 (numri i protokollit pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe çertifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, pas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 19/2 pika 2 Ligjit 10018/2008 *“Për Avokaturën e Shtetit”*, i ndryshuar. Vendimi është botuar në fletoren zyrtare Nr.171 datë 22/11/2023. Në datën 04.12.2023 me shkresën nr.5537/4 prot, Avokatura e Shtetit i ka përcjellë vendimin për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton i ekzekutuar, **datë 01.02.2024, në vlerën 213,299 lekë, përtej afateve ligjore të përcaktuara.**

- Vendimi datë 21.09.2023 **“R. kundër Shqipërisë”** i cili është bërë përfundimtar në 21.09.2023, duke akorduar një vlerë prej 4,000 Euro nga GJEDNJ. Avokatura e Shtetit me marrjen dijëni të vendimit nga GJEDNJ, ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.4970 prot., dt.03.10.2023 për përkthimin e vendimit. Me shkresën nr.4970/2 prot. datë 16.10.2023 (numri i protokollit pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe çertifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, pas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 19/2 pika 2 Ligjit 10018/2008 *“Për Avokaturën e Shtetit”*, i ndryshuar. Vendimi është botuar në fletoren zyrtare Nr.151 datë 18/10/2023. Në datën 26.10.2023 me shkresën nr.4970/3 prot, Avokatura e Shtetit i ka përcjellë vendimin për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton i ekzekutuar, **datë 12.01.2024, në vlerën 427,210 lekë, nga të cilat 2,010 lekë janë interesa, përtej afateve ligjore të përcaktuara.**

- Vendimi datë 30.11.2023 **“A. dhe 2 kërkesa të tjera kundër Shqipërisë”** i cili është bërë përfundimtar në të njëjtën datë, 30.11.2023. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të nënit 6/1 të Konventës sa i takon mosekzekutimit të vendimeve dhe i ka akorduar 8,200 Euro shpërblim dëmi jo pasuror dhe 250 Euro shpenzime gjyqësore. Avokatura e Shtetit me marrjen dijëni të vendimit nga GJEDNJ,-së ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar MD me shkresën Nr.6445/1 prot dt. 14.12.2023 për përkthimin e vendimit. Me shkresën Nr.26 prot., datë 03.01.2024 (me këtë numër protokolluar pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe çertifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, botuar në fletoren zyrtare Nr. 5 datë 09/01/2024. Në datën 11.01.2024, shkresën Nr.26/3prot., Avokatura e Shtetit i ka përcjellë vendimin për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton e ekzekutuar, me datë 04.03.2024 në vlerën 898,464 lekë **përtej afateve ligjore të përcaktuara.**

- Vendimi datë 06.07.2023 **“E. SHPK dhe të tjerë kundër Shqipërisë”** i cili është bërë përfundimtar me datë, 06.10.2023. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje e nenit 6/1 sa i takon tejzgjatjes së procedurave,duke urdhëruar ekzekutimin e vendimeve vendase dhe akordon shpërblim dëm jopasuror për të gjithë kërkuesit në shumën 23,800 Euro. Avokatura e Shtetit me marrjen dijëni të vendimit nga GJEDNJ,-së ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar MD me shkresën Nr.3642/1 prot dt. 13.07.2023 për

përkthimin e vendimit. Me shkresën Nr.3642/4 prot., datë 02.08.2023 (me këtë numër protokolluar pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe çertifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare, botuar në fletoren zyrtare Nr.116 datë 03.08.2023. Në datën 07.08.2023 me shkresën Nr.3642/5prot., Avokatura e Shtetit i ka përcjellë shkresën për ekzekutimin financiar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në datën 28.09.2023, KM ka miratuar VKM nr.548, "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së datë 06.07.2023, për çështjen **‘E. SHPK dhe të tjerë kundër Shqipërisë’**". Këshilli i Ministrave në dispozitivin e tij ka vendosur *‘Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, për çështjen “E. SHPK dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për kërkesat nr.63986/10 , nr.11487/11 (C), nr.48963/11 (Sh), nr.45719/12 (K), nr.45720/12 (B) dhe nr.71642/12 (G), sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.....Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuësve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi’*. Nga ana e Ministrisë së Financave rezulton e likuiduar me datë 08.11.2023, **përtej afateve ligjore të përcaktuara**, vlera totale prej 2,562,789 lekë nga të cilat 18,299 lekë janë interesa.

- Vendimi datë 07.11.2023 **‘D dhe të tjerë kundër Shqipërisë’** i cili është bërë përfundimtar në 07.02.2024, bazuar në nenin 44/2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka deklaruar kërkesën të pranueshme, sa i takon shkeljes së aspektit procedural të nenit 2 të Konventës duke akorduar shpërblim të drejtë, si dëm moral në vlerën 168.000 Euro për të gjithë kërkuësit si dhe 8000 Euro shpenzime gjyqësore. Avokatura e Shtetit me marrjen dijeni të vendimit nga GJEDNJ, ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke iu drejtuar fillimisht me shkresën nr.6586 prot., dt.22.11.2023 Ministrisë së Drejtësisë për përkthimin e vendimit. Me shkresën nr.1470/6 prot. datë 05.12.2023 (numri i protokollit pranë ASH) Ministria e Drejtësisë ka kthyer kopje të vendimit të përkthyer dhe çertifikuar duke informuar dhe për botimin e tij në fletoren zyrtare. Vendimi është botuar në fletoren zyrtare Nr.54 datë 29/03/2024. Në datën 14.02.2024 me shkresën Nr.725/1 Avokatura e Shtetit i ka përcjellë shkresën për ekzekutimin financiar Kryeministrisë. Në datën 27.03.2024, KM ka miratuar VKM nr.177, "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së datë 07.11.2023, për çështjen "Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë". Këshilli i Ministrave në dispozitivin e tij ka vendosur *‘Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.11.2023, për çështjen “D. dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr.63543/09, nr.46707/13, nr.46714/13, nr.12720/14, përfundimtar në datën 7.2.2024, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij...Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në VKM, në favor të të gjithë kërkuësve nr.63543/09 , nr.46707/13 , nr.46714/13 , nr.12720/14, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar. Në rast mospagimi brenda afati 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, për shumat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ekzekutimi përfundimtar nga MFE pritët të bëhet gjatë vitit 2024.*

Gjetja 7: Në 2 procedura të komunikuara gjatë vitit 2023, detyrimi i vendosur është i pa ekzekutuar, ndërsa në 4 procedura të vitit 2023 detyrimet janë ekzekutuar jashtë afatit.

Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit ka paraqitur kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projekt-vendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në zbatim të nenit 19/2 pika 4 e Ligjit 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, për dy procedura.

- Me shkresën nr. 3645/5 prot., dt.07.08.2023 për çështjen “E. SHPK dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për të cilën është marrë vendimi nr.548 dt.28.09.2023 “Për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, për çështjen “E SHPK dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

- Me shkresën nr. 725/1 prot., dt.14.02.2023 për çështjen “D. dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për të cilën është marrë vendimi nr.177 dt.27.03.2024 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.11.2023, për çështjen “D. dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

Vendime të GJEDNJ-së, detyrime të mbartura në vitin 2023

1. D. kundër Shqipërisë, data e vendimit përfundimtar nga GJEDNJ 14.09.2015, vlera e akorduar nga Gjykata prej 15,600 euro. Akoma nuk është miratuar vendimi i këshillit të ministrave në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 19/2 pika 5 e Ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. Detyrimi konform nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar ku citohet ‘Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë, brenda tre muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë’ duhej të ishte ekzekutuar brenda datës 14.12.2015. Shkresa e fundit nga Avokatura e Shtetit nr.3150 prot, datë 24.06.2022 me të cilën i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe ka kërkuar miratimin. Gjatë vitit 2023 ASH nuk ka ripërsëritur kërkesën.

2. D. N. kundër Shqipërisë (vendimi R), data e vendimit përfundimtar nga GJEDNJ 17.03.2016, vlera e akorduar nga Gjykata prej 4,417,750 euro i cili duhej të ishte ekzekutuar brenda datës 17.06.2016. Eshhtë miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së nr.613 datë 31.08.2016 “Për ekzekutimin e vendimit R. kundër Shqipërisë”. Nga ana e MFE ky vendim nuk është zbatuar vetëm sa i takon çështjes “D. N”. Me shkresën nr. 22882/1 prot., atë 17.01.2019, Ministria e Financave shprehet se vazhdimi me procedurat e ekzekutimit lidhur me aplikimin nr. 48522/10 “D. dhe N. kundër Shqipërisë”, duhet të bëhet pas qartësimit të situatës ligjore nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas. **Vendimi i GJEDNJ-së nuk është ekzekutuar për shkak të një konflikti në lidhje me trashëgiminë midis kërkuësve në GJEDNJ-së dhe pretenduesve të saj.** Më konkretisht, pranë gjykatave vendase është bërë objekt konflikti gjyqësor, në bazë të pretendimeve për pasurinë trashëgimore, shuma e përfituar nga vendimi i GJEDNJ-së. Trashëgimtarë të tjerë të ish pronarit kanë pretenduar 2/3 e shpërblimit të akorduar nga GJEDNJ. Me vendimin e formës së prerë 4349/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur ndër të tjera: “Pranimi pjesërisht i padisë. Detyrimi i të paditurve A. D. etj. Të njohin trashëgimtarë në 2/3 pjesë të vlerës 4,416,900 Euro të përcaktuar si detyrim në vendimin e GJEDNJ-së, urdhëruar ekzekutimi i tij me VKM 613, datë 31.08.2016.”

3. S. kundër Shqipërisë, data e vendimit përfundimtar nga GJEDNJ 28.05.2018, vlera e akorduar nga Gjykata prej 13,447,300 euro. Akoma nuk është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 19/2 pika 5 e Ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. Detyrimi konform nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar

ku citohet ‘Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë, brenda tre muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë’ duhej të ishte ekzekutuar brenda datës 28.08.2018. Shkresa e fundit nga Avokatura e Shtetit nr.2978/2 prot, datë 04.05.2022 me të cilën i është drejtuar MFE në kuadër të planifikimit buxhetor për ekzekutimin e këtij vendimi. Gjatë vitit 2023 ASH nuk ka ripërsëritur kërkesën.

Konstatim: Për vitin 2023, u konstatua se tre vendime të GJEDNJ-së, vijojnë të mbartura dhe të pa ekzekutuara.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.5, datë 06.09.2024, nga avokati i shtetit e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.E. D. me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi subjektiv: Në lidhje me këto vendime, theksojmë se nga ASH janë iniciuar procedurat e ekzekutimit brenda afateve ligjore për të treja vendimet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Obervacioni i paraqitur nuk paraqet prova të reja dhe nuk merret në konsideratë.

Detyrime të mbartura/likujduara me vonesë gjatë vitit 2023 nga Vendimet e GJEDNJ-së.

“S. kundër Shqipërisë”, akorduar shuma 17,500 euro, komunikuar më 21.01.2020, data e formës së prerë më 21.05.2020. Likujduar me datë 26.01.2023 në vlerën 2,259,654 lekë, interesa në masën 196,404 lekë.

“P. kundër Shqipërisë”, akorduar shuma 13,450 euro, komunikuar datë 11.06.2019, data e formës së prerë më 11.09.2019. Likujduar me datë 26.01.2023 në vlerën 1,759,092 lekë, interesa në masën 173,337 lekë.

“S. kundër Shqipërisë”, akorduar shuma prej 24,600 euro, komunikuar datë 13.12.2022, data e formës së prerë më 13.03.2023. Likujduar me datë 04.09.2023 në vlerën 2,729,976 lekë, interesa në masën 41,196 lekë.

Konkluzion: Grupi i auditimit konstatoi se gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë tre vendime të GJEDNJ-së, të mbartura, duke shkaktuar detyrimin për kryerjen e pagesave për interesa në total 410,937 lekë.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.5, datë 06.09.2024, nga avokati i shtetit e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.E.D. me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi subjektiv: Në lidhje me këto vendime, theksojmë se nga ASH janë iniciuar procedurat e ekzekutimit brenda afateve ligjore për të tre vendimet’.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Obervacioni i paraqitur nuk shoqërohet me shkresa zyrtare që nga ana e Avokaturës së Shtetit, të jenë përcjellë për ekzekutim brenda afatit ligjor në Ministrinë e Financave dhe nuk merret në konsideratë.

Raportimi mbi vendimet e GJEDNJ-së në zbatim të Udhëzimit plotësues të MFE Nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.

Referuar UMF Nr.9 dt. 20.03.20218’’Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’’ dhe Nr.2, datë 19.01.2023, pika 126.5, germa ”c”, Avokatura e Shtetit, brenda datës 10 Maj dhe 10

Shtator të çdo viti buxhetor, si dhe sa herë kërkohet nga MFE, raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, në rugë zyrtare shkresore dhe elektronike për sa vijon: Avokatura e Shtetit dërgon regjistrin e përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queue).

Në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi ligjor për vitin 2023, nga ASH me e-mail datë 16.06.2023, si dhe me e-mail datë 12.09.2023 dhe shkresën Nr. 4831/1, datë 30.10.2023 është dërguar në MFE, informacioni mbi detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar.

Totali i vlerës së detyrimeve të komunikuar nga vendimet përfundimtare të GJEDNJ-së për vitin 2023 është në masën **280,620 euro** nga të cilat **95,920 euro** janë ekzekutuar.

Nga totali i ekzekutuar (95,920 Euro), vlera prej 27,840 euro/2,955,246 lekë është ekzekutuar në vitin 2024 që i përkasin 6 procedurave.

Mbetur pa u ekzekutuar për vitin 2023 në total janë **8,700 euro** që i përkasin çështjeve “L. C. kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjerë” dhe “Ç dhe S. SHPK kundër Shqipërisë”.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Aktkonstatimit Nr.6, datë 06.09.2024, nga Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Gjykatat Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar znj.M.I, me shkresën Nr.3316/4, prot., datë 18.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/3 prot., datë 20.09.2024.

Pretendimi i subjektit: “Në fq 11, të dokumentit Akt Konstatim Nr.6, lidhur me raportimin në Ministrinë e Financave evidentohet si vijon: ...nga ASH është tejkaluar afati si dhe nuk është respektuar forma e kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit...Raportimi i Avokaturës së Shtetit drejtuar Ministrisë së Financave është kryer brenda afatit të përcaktuar me e mail zyrtar. Ndërsa përcjellja me shkresë...ka kaluar ciklin e brendshëm të firmosjes...Gjithashtu sa i përket formës së kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit nuk kemi pasur kontestime nga Ministria e Financave...”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i subjektit merret në konsideratë, për aq kohë sa raportimi nuk ka sjellë pengesa në hartimin e rakordimit e të dhënave me Ministrinë e Financave, por konstatimi i KLSH duhet mbajtur në konsideratë nga subjekti, për përmbushjen e detyrimit ligjor që buron nga UMF Nr.2, datë 19.01.2023 nga ku mos respektimi, mund të çojë në pasojë për mos rakordimin në kohë të të dhënave”. Ndryshimet u pasqyruan në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Funksionimi i Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.

Avokatura e Shtetit, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të GJEDNJ-së duhet të konsultohet me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së sipas parashikimeve në nenin 19/8 të Ligjit Nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Ky Këshill, duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit, për sa i përket:

- a) gjetjes së një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve, që ka për qëllim t’i japë fund çështjes;
 - b) shqyrtimit të të gjitha materialeve/ dokumenteve që disponojnë organet shtetërore, në lidhje me çështjen e shqyrtuar nga GJEDNJ;
 - c) përcaktimit të një plani pune/veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave konkrete, në kuadër të ekzekutimit të një vendimi;
 - ç) paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të planit të punës/veprimit;
 - d) komunikimeve për informimin e publikut dhe mediave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit.
- Për vitin 2023 ky këshill nuk ka funksionuar. Grupit të auditimit iu vu në dispozicion shkresa e Avokatit të Shtetit mbi propozimin e anëtarëve të Këshillit Konsultativ për Çështjet e

GJEDNJ-së nr.2167 prot., dt. 03.05.2024 si dhe urdhri nr.91, datë 04.06.2024 i Kryeministrit “Për një ndryshim në urdhrin nr.34 datë 04.02.2019 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ për çështjet e Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut” i ndryshuar të përbërë nga pesë anëtarë.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi mbi ecurinë e detyrimeve për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ-së për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 deri 31.12.2023) rezultoi:

☞ Regjistri i posaçëm çështjeve të trajtuara nga GJEDNJ, nuk rezultoi i plotësuar në të gjitha rubrikat e formatit të miratuar me urdhrin nr.375/1 datë 21.10.2022, duke mospërfshirë nr e kërkesës.

☞ Për vitin 2023, u konstatua se tre vendime të GJEDNJ-së, vijojnë të mbartura dhe të paekzekutuara.

☞ Në 6 procedura të komunikuar gjatë vitit 2023, detyrimet e vendosura janë ekzekutuar jashtë afatit.

☞ Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë tre vendime të GJEDNJ-së, të mbartura, duke shkaktuar detyrimin për kryerjen e pagesave për interesa në total 410,937 lekë.

☞ Për vitin 2023 Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së nuk ka funksionuar.

2.2 “Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre”.

Në zbatim të pikës 2.2 “Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre”, nga auditimi rezultoi se vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit të administruara nga ASH deri me datë 31.12.2023, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi, të dhënat janë shprehur në tabelën më poshtë:

Ceshitje ARBITRAZHI		Vendime Arbitrazhi		Kosto Perfaqesimi		Kosto Ekspertimesh		Kosto administrative	
ICC 20564/EMT/GR	H. srl kunder MIE	€ 142,975.78							
ICC 21349/GR	Kosto perfaqesimi Bankers Petroleum Albania ltd kunder MIE/AKBN/ALBPETROL			€ 1,750,000.00	\$ 880,000.00				
ICC 21349/GR	Sherbim ekspertimi BPAL kunder MIE/AKBN/ALBPETROL								
ICC 21349/GR	B. P. Albania ltd kunder MIE/AKBN/ALBPETROL	Ne proces	Ne proces						
ICC 22676/GR	G. O. kunder MIE, AKBN, ALBPETROL	€ 14,451.68	\$12,870,612.10						
ICC 22919/GR	H. srl	Fituar	Fituar						
ICC 23998/MHM (C-24011/MHM)	Bashkimi i shoqërive "JV C & A T.S.", kunder ARRSH	€ 573,081.13	\$44,262,682.41						
ICC 24140/MHM	Kosto perfaqesimi C. D. kunder AKUM/MIE			€ 1,099,000.00					
ICC 24140/MHM	Sherbim ekspertimi C. D. spa kunder AKUM/MIE					\$750,000.00			
ICC 24140/MHM	Shpenzime administrative C. D. kunder AKUM/MIE							\$ 35,700.00	
ICC 24140/MHM	Shpenzime gjyqesore C. D. spa kunder AKUM/MIE							€ 2,647.00	€7,612.50
ICC 24140/MHM	Shoqëria C. D. s.p.a, kunder AKUM/MIE	Ne proces	Ne proces						
ICISD ARB/20/37	Sherbim ekspertimi M.C.T. kunder AKUM/MIE					€ 360,000.00			
ICSID ARB/14/26	A A.sh.p.k., A. N.	Fituar	Fituar						
ICSID ARB/15/28	H. srl, etj.kunder MIE	€ 107,709,238.53	\$ 2,346,442.13						
ICSID ARB/15/28	Kosto perfaqesimi RSH per kundershkim ekzekutim vendim arbitrazhi te HYDRO ne Belgjike			€ 760,000.00					
ICSID ARB/15/28	H srl, kunder MIE	Ne proces	Ne proces						
ICSID ARB/15/28	Kosto perfaqesimi RSH në procedurat e Rishikimit të Vendimit të Arbitrazhit të datës 24.4.2019 (Hydro)			€ 950,000.00					
ICSID ARB/15/28	Kosto perfaqesimi RSH per kundershkim ekzekutim vendim arbitrazhi te H.			€ 760,000.00					

ICSID ARB/15/28	Kosto perfaqesimi RSH per kundershitim ekzekutim vendim arbitrazhi te H. ne I.			€ 656,404.00							
ICSID ARB/15/28	Kosto perfaqesimi RSH per kundershitim ekzekutim vendim arbitrazhi te H.					£ 700,000.00					
ICSID ARB/20/37	Kosto perfaqesimi RSH/APD ndaj Durres K. Sh.			€ 1,900,000.00							
ICSID ARB/20/37	M.C. T. Container Terminal kunder RSH/APD	Ne proces	Ne proces								
ICSID ARB/23/9	EMS S & T. G. kunder RSH/APD	Ne proces	Ne proces								
PCA 2018-49	Kosto perfaqesimi V. I. s.r.l. kunder MBZHR			€ 750,000.00							
PCA 2018-49	V. I. s.r.l. kunder MBZHR	Ne proces	Ne proces								
PCA 2023-43	Kosto perfaqesimi P P Sha kunder RSH/ALBPETROL			€ 1,790,000.00							
PCA 2023-43	P P Sha kunder RSH/ALBPETROL	Pez/Terhiqet	Pez/Terhiqet								
PCA 2023-64	Kosto perfaqesimi M. N. kunder RSH			€ 675,000.00							
PCA 2023-64	Shpenzime gjyqesore M. N. kunder RSH						€ 100,000.00				
PCA 2023-64	M. N. kunder RSH	Ne proces	Ne proces								
SCC 2021/155	Sherbim ekspertimi I. H. kunder RSH						€ 367,100.00				
SCC 2021/155	Sherbim ekspertimi I. H kunder RSH						€ 242,928.00				
SCC 2021/155	Shpenzime gjyqesore IV. kunder RSH							€ 2,630.35		£ 1,300.09	
SCC 2021/155	Kosto perfaqesimi IV. H kunder RSH			€ 1,650,000.00							
SCC 2021/155	IV. H. kunder RSH	Ne proces	Ne proces								
	Sherbim konsulence ligjore per parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarreshjeve nderkombetare peritudhe 2 vjecare			€ 600,000.00							
	D. G. shpk/D. E.	Ne proces	Ne proces								
Totali		€ 108,439,747.12	\$ 59,479,736.64	€ 13,340,404.00	€ 880,000.00	£ 700,000.00	€ 1,070,028.00	\$ 750,000.00	€ 5,277.35	\$ 35,700.00	£ 8,912.59

Vendime për të cilat Republika e Shqipërisë ka detyrimet si më poshtë:

Ceshtja	Paditesi	I padituri	Dëmshtëpërlim/Detyrim		Kosto Arbitrazhi/Ligjore/Procedurash/Administrative	
			Euro	USD	Euro	USD
ICSID ARB 15/28	H. etj.	MIE	€ 99,487,000.00		€ 8,222,238.53	\$ 2,346,442.13

ICC 22676/GR		MIE, AKBN, Albpetrol		\$ 12,577,852.10	€ 14,451.68	\$ 292,760.00
ICC 23998/MHM (C-24011/MHM)	Bashkimi i shoqërive "JV C.	ARRSH		\$ 44,262,682.41	€ 573,081.13	
ICC 20564/EMT/GR	H.srl	MIE			€ 142,975.78	
Total				€ 99,487,000.00	\$ 56,840,534.51	€ 8,952,747.12
						\$ 2,639,202.13

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Vendime për të cilat Republika e Shqipërisë ka të drejta(cështje të fituara):

Cështja	Paditesi	I padituri	Dëmshpërblim/Detyrim		Kosto Arbitrazi/Ligjore/Procedurash/Administrative		
			Euro	USD	Euro	USD	GBP
ICSID ARB 14/26	A.A"sh.p.k.,	MTM			€ 2,407,000.00	\$ 837,125.71	£ 106,755.00
ICC 22919/GR	H. srl	MIE			€ 731,280.00		£ 1,795.60
ICC 20564/EMT/GR	H. srl	MIE	€ 6,875,692.00			\$ 325,000.00	
Total			€ 6,875,692.00	\$ -	€ 3,138,280.00	\$ 1,162,125.71	£ 108,550.60

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Nga auditimi në ASH lidhur me vendimet e arbitrazhit të njohura/në proces njohje për vitin 2023, rezulton se janë 6 vendime me të dhënat e shprehura në tabelat si më poshtë:

Detyrimet e paditësve ndaj RSH nga vendimet e arbitrazhit 2023

Çështja	Vendime arbitrazhi 2023		
	Detyrimi në Euro	Detyrimi në USD	Detyrimi në GBP
ICC Case 20564	6,875,692	325,000	
ICC Case 22919/GR	791,280		1795.60
ICSID ARB/14/26	2,407,000	837,125.71	106,755
TOTALI	10,013,972	1,162,125.71	108,550.6

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Detyrimi i RSH-së nga vendimet e arbitrazhit 2023

Çështja	Vendime arbitrazhi 2023	
	Detyrimi në Euro	Detyrimi në USD
ICSID Case ARB/15/28	107,709,238.5	2,346,442.13
ICC Case 22676/GR	14,451.68	12,870,612.1
ICC Case 23998/MHM (C24011/MHM)	573,081.13	44,262,682.41
ICC Case 20564	142,975.78	
TOTALI	108,439,747.08	59,479,736.64

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi auditimit

Për njohjen dhe kontabilizimin e të drejtave dhe detyrimeve lidhur me këto vendime u ushtrua auditim edhe në subjektet, që janë palë e paditur në këto vendime si më poshtë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Albpetrol SHA-Patos.

Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administron Avokatura e Shtetit për çështjen ICSID ARB/14/26 tribunali Arbitrazhit është shprehur në favor të Republikës së Shqipërisë/**Ministria Turizmit dhe Mjedisit**.

Pala paditëse “A. A.” SHPK, ka iniciuar procesin e anulimit për të cilin tribunali i arbitrazhit ka dalë me vendim datë 18.04.2022 njoftuar palëve me 6 Maj 2022.

Detyrimet e palës paditëse sipas vendimit të arbitrazhit janë:

- 427,488.72 USD, kosto dhe shpenzime të procesit të arbitrazhit
- 1,857,000 Euro shpenzime gjyqësore (shpenzimet për studion ligjore të kontraktuar, ekspertin)
- 106,755 GBP shpenzime administrative.

Detyrimet sipas Vendimi i Anullimit janë:

- në total është **409,636.99 USD** dhe **550,000 Euro** i cili përbëhet nga;
- kostot e procedurave duke përfshirë shpenzimet e Tribunalit;
- kostot e përfaqësimit dhe shpenzimet e RSH. Kjo shumë duhet të paguhet brenda njëzet e tetë (28) ditëve nga data e dorëzimit të Vendimit. Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë mujor, derisa të paguhet kostot;
- Penaliteti: Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhet kostot.

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)** në zbatim të pikës 2.2 të programit të auditimit “*Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe*

likuidimin e tyre”, në lidhje me pasqyrat financiare (llogarite e detyrimeve dhe të drejtave) mbi detyrimet e vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare dhe të Arbitrazhit Ndërkombëtare rezulton:

Gjetja 8: Tek llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare nuk rezulton të ketë vendime të kontabilizura në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe detyrimi është në shumën 0 lekë.

Nga përlllogaritja e bërë nga grupi i auditimit deri me datë 31.12.2023, totali i të drejtave të principalit është në shumën 2,407,000 Euro, 837,125.71 Usd dhe 106,755 £, si dhe interesat në shumën 3,011,883.31 Euro, 635,509.56 USD dhe 158,703.19 £.

Totali i principalit duke përfshirë dhe interesat deri 31.12.2023 është në shumën **5,418,883.31 Euro, 1,472,635.27 USD dhe 265,458.19 £.**

3. ICSID ARB/14/26						
Vendimi i arbitrazhit datë 03.03.2020 , Procesi I njohjes nuk ka filluar akoma ne Gjykatë të Apelit Tiranë						
Te drejta te fituara						
Pala e paditur RSH MTM	Detyrim/Principal	Interes	Detyrim/Principal	Interes	Detyrim/Principal	Interes
Kostot dhe shpenzime te procesit te arbitrazhit + 2% interes I perbere mujor nga dita e 28 deri ne momentin e shlyerjes			\$427,488.72	\$635,509.56		
Shpenzime gjyqësore (shpenzimet për studion ligjore të kontraktuar, ekspertin) + 2% interes I perbere mujor nga dita e 28 deri ne momentin e shlyerjes	1,857,000.00 €	2,760,637.16 €				
Shpenzime administrative + 2% interes I perbere nga dita e 28 deri ne momentin e shlyerjes					£106,755.00	£158,703.19
Kosto e procedurave duke përfshirë shpenzimet e Tribunalit (Procesi I anulimit)			\$409,636.99			
Kostot e përfaqësimit dhe shpenzimet e RSH (Procesi I anulimit) + interesat (2% interes I perbere mujor) nga dita e 29 e shpalljes vendimit deri ne shlyerje	550,000.00 €	251,246.14				
Totali	2,407,000.00 €	3,011,883.31 €	\$837,125.71	\$635,509.56	£106,755.00	£158,703.19

Burimi: ASH/përpunuar nga grupi i auditimit

ASH me shkresën nr.6067, datë 21.11.2023, ka rikujtuar MTM, si institucion interesuar për njohjen dhe kryerjen e procedurave për dhënie fuqi juridike vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit vendas, ndërkohë që ASH ka vijuar me procedurat për zyrtarizimin dhe certifikimin e vendimit të arbitrazhit, duke ju drejtuar ICSID, procedurë që ka vazhduar deri në qershor 2024. Në 2024 është dërguar vendimi zyrtar nga ICSID dhe është bërë apostulimi i saj në ambasadën e RSH në Washington.

Nga MTM deri në 31.12.2023 nuk është marrë masë për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit bazuar në Kodin e Procedurës Civile (KPrC), neni 393 në të cilin në mënyrë eksplicite përcaktohet se “vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim, ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes. Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj” si dhe neni 398 “Vendimi i gjykatës së shtetit të

huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi”.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit të Auditimit me shkresat Nr.4403/3, prot., datë 17.10.2024 dhe Nr. 4234/2, datë 04.11.2024 protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/9 prot., datë 18.10.2024, dhe Nr.853/12, datë 08.11.2024.

Pretendimi subjektiv:” ...1. Me shkresën nr. 4872/3 Prot., date 16.09.2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka depozituar kërkesën për njohje të dy vendimeve të arbitrazhit pranë Gjykatës Apelit, Tiranë.

2. Në vijim, Gjykata me shkresën nr.17468 prot., date 24.09.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr.4872/5 prot., datë 26.09.2024, kërkon plotësimin e të metave lidhur me kërkesën për njohje dhe dhënien fuqi të vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare Arbitrazhit,.....

3. Në përgjigje të kërkesës së gjykatës, MTM me shkresën nr. 4872/2 Prot., datë 07.10.2024, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Observacioni i subjektivit merret pjesërisht në konsideratë përse i përket procedurave të ndjekura nga MTM për njohjen e vendimit, por rekomandimi i KLSH do qëndrojë deri në ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit.

Nga auditimi i ushtruar në **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë**, AKBN dhe Albpetrol SH.A. në zbatim të pikës 2.2 të programit të auditimit “*Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre*”, në lidhje me pasqyrat financiare (llogaritë e detyrimeve dhe të drejtave) mbi detyrimet e vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtare rezultojnë se nga informacioni i venë në dispozicion nga Avokatura e Shtetit, janë 2 çështje Arbitrazhi Ndërkombëtar, ku palë interesi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN dhe Albpetrol SH.A.

Për çështjen **Case 22676/GR GBC**, ASH ka vënë në dijeni MIE, me shkresën Nr.1526/23, datë 07.07.2021 për njohjen e vendimit nga Gjykata e Apelit. Për çështjen Case 20564/EMT/GR, MIE ka njoftuar Avokaturën e Shtetit me shkresën Nr.3366/1, datë 18.07.2023, mbi vendimin e Gjykatës së Apelit nr.131, datë 03.05.2023 për dhënie fuqi juridike vendimit të arbitrazhit.

1. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim për çështjen ICC Case nr. 22676/GR G v. MIE, AKBN & Albpetrol datë 06.07.2020. Në total detyrimi i RSH (*MIE/AKBN*) ndaj paditësit është **12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+ interesa**, i cili përbëhet nga:

- vlera 12,577,852.1 USD, si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencë Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit;

- Paditësi duhet të paguajë 60 % të kostove administrative dhe të paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove.

- 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, me kërkesë të shoqërisë “G. O. Ltd” përfaqësuar nga dega e shoqërisë së huaj T. A. Ltd ka vendosur: Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit nr. 22676/GR.

Avokatura e Shtetit ka ushtruar të drejtën e rekursit duke kërkuar: Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes si dhe pezullimin e ekzekutimit. Pezullimi i ekzekutimit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Aktualisht çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe akoma nuk ka një datë të planifikuar për zhvillimin e seancës.

Totali i interesave për t'u paguar nga RSH deri në 31.12.2023 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë 2,520.14 € dhe 51,052.53 USD. Këto vlera do të shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit i cili në total është **12,921,664.63 USD** dhe **16,971.82 Euro**.

ICC Case nr. 22676/GR datë 06.07.2020				
Vendimi Arbitrazhi 06.07.2020, Njohur ne Gjykatën e Apelit me vendimin nr 49 dt. 04.05.2021				
Detyrime ndaj paditësve				
	Principal ne €	Interes ne €	Principal ne \$	Interes ne \$
Dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencë Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit			\$12,577,852.10	
MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit detyrimin + Interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.	14,451.68 €	2,520.14 €	\$ 292,760	\$ 51052.53
Totali I dëmshpërblimit			\$12,577,852.10	
Totali detyrimi dhe interesi I kostove administrative	16,971.82 €		343,812.53	
Totali	16,971.82 €		12,921,664.63	

Burimi: Avokatura e Shtetit/Përpunuar nga grupi I auditimit

2. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marë vendim datë 07.09.2018 për çështjen ICC Case No. 20564/EMT/GR k. RSH, i cili vendosi:

- T'i paguhen RSH penaltetet për vonesa në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë,
- Dëmshpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 9.1.2018 deri në pagesën e plotë,
- rimbursim të RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.
- detyrim i RSH për t'i rimbursuar Paditësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën 142,975.78 Euro.

1. ICC Case No. 20564/EMT/G				
Vendimi i arbitrazhit 07.09.2018, Njohur vendimi me Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë				
Detyrime sipas vendimit te Arbitrazhit				
Pala paditese H.	Detyrim/Principal	Interes	Detyrim/Principal	Interes
Kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave	142,975.78 €			
Totali	142,975.78 €		0.00 €	\$0.00
Te drejta te fituara sipas arbitrazhit				

Pala e paditur RSH MIE	Detyrim/Principal	Interes	Detyrim/Principal	Interes
Penalite për vonesat + Interesa periudha 16/07/2011 - Ne ekzekutim	1,693,157.00 €	Libor 12 mujor + 2%		
Dëshmipërbim + Interesa periudha 09/01/2018 - Ne ekzekutim	5,182,535.00 €	Libor 12 mujor + 2%		
Tarifa dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.			\$325,000.00	
Totali	6,875,692.00 €	0.00 €	\$325,000.00	\$0.00

Burimi: Avokatura e Shtetit/Perpunuar nga grupi I auditimit

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 ka njohur çështjen ICC Case No. 20564.

Me shkresën nr. 3666/1 datë 18.07.2023 MIE i ka dërguar një kopje Avokaturës së Shtetit të vendimit të Gjykatës së Apelit të cilës i është dhënë fuqi juridike.

Nga MIE deri në 31.12.2023 nuk është janë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të MIE, konstatohet se vendimet e Arbitrazhit të njohura me vendime respektive të Gjykatës së Apelit me nr. 49 datë 04.05.2021 dhe nr.131, datë 03.05.2023, nuk janë kontabilizuar në të drejta dhe detyrime në llogaritë kontabël kompetencë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si rrjedhojë nuk janë marrë masa për likuidimin e çështjeve të sipër përmendura, jo në përputhje me *UMF nr 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar me nr UMF nr 5, datë 21.2.2022.*

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)** në zbatim të pikës 2.2 të programit të auditimit “*Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre*”, në lidhje me pasqyrat financiare (llogarite e detyrimeve dhe të drejtave) mbi detyrime të vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare dhe të Arbitrazhit Ndërkombëtare rezulton se:

Konstatim: Avokatura e Shtetit, me shkresën Nr.253/1, datë 21.02.2018 protokolluar në AKBN Nr.2554, datë 22.02.2018, ka përcjellë vendimin e arbitrazhit për çështjen ICC Case 21349/GR. Ky vendim është njohur dhe kontabilizuar nga AKBN në vitin 2018.

Tek llogaria *Detyrime Afatshkurtra #detyrimet*, është në vlerën **124,643,355** lekë.

Detyrimi i sipërcituar lidhet me çështjen ICC Case 21349/GR. Vendimi i ndërmjetëm është marrë më datë 01.02.2018 nga tribunali i Arbitrazhit me palë B. P. dhe Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë MIE, Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore AKBN i cili vendosi:

-AKBN detyrohet t’i paguajë B. vlerën 1,161,309.37 USD, kostot e përballuara nga B. deri në këtë fazë të procedurave në lidhje me ankimimin.

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 nuk ka pasur lëvizje të llogarisë së detyrimeve dhe si rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë likuidim.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit të Auditimit me shkresën Nr.3130/5, prot., datë 28.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/10 prot., datë 31.10.2024.

Pretendimi subjektit: “...Detyrimi i sipërcituar ka lindur në vitin 2018 nga vendimi i tribunalit të Arbitrazhit....Gjithashtu AKBN e ka planifikuar dhe do të vijojë ta planifikojë këtë detyrim në buxhetin e saj deri në likuidimin e tij, por aktualisht vështirësitë financiare dhe mungesa e likuiditetit nuk mundësojnë shlyerjen e këtij detyrimi”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Subjekti e ka pranuar rekomandimin e KLSH-së për rrjedhojë, observacioni **merret** në konsideratë.

Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administrojnë Avokatura e Shtetit rezultojnë se nuk ka çështje që i përket ALBPETROL SHA-Patos.

Nga auditimi i ushtruar në ALBPETROL SHA-Patos, në zbatim të pikës 2.2 të programit të auditimit “Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre”, në lidhje me pasqyrat financiare (llogaritë e detyrimeve dhe të drejtave) mbi detyrime të vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar rezultojnë se:

Tek llogaritë përkatëse të pasqyrave financiarë nuk ka vendime të kontabilizuara. Gjithashtu dhe nga kryqëzimi i të dhënave me Avokaturën e Shtetit nuk rezultojnë të ketë çështje të cilat i përkasin Albetrol SHA.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit të Auditimit me shkresën Nr.3316/6, prot., datë 01.11.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 853/10 prot., datë 04.11.2024.

Pretendimi i subjektit: “...Sa i përket vendosjes në pasqyrat financiare të institucioneve është veprim financiar i institucioneve...”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me komentën e subjektit për rekomandimin 7.1, sqarohet se pretendimi i subjektit merret pjesërisht në konsideratë duke u bërë ndryshimet në Rekomandimin 7.1 si dhe në pjesën “Përmbledhja ekzekutive”, fq 8, rekomandimi 5.1.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandohet marrjen e masave duke pasur parasysh:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar rezultojnë se:

- për 2 vendime arbitrazhi (*ICC Case 22919/GR dhe ICSID ARB/14/26*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që kanë paditësit ndaj RSH, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit/të paditurve (*RSH/MIE, MTM*) në procedurat e njohjes të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile (K.Pr.C), neni 393 dhe 398, duke sjellë për pasojë mos arkëtimin në buxhetin e shtetit të vlerës prej **10,013,972 Euro, 1,162,125.71 USD dhe 108,550.6 GBP**.

- për 4 vendime arbitrazhi (*ICSID Case ARB/15/28, ICC Case 22676/GR GBC, ICC Case 23998/MMH dhe ICC Case 20564*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që ka RSH ndaj paditësve, ka vonesa në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit në zbatim të nenit 398 të Kodit të Procedurës Civile, nga mosveprimi në kohë i paditësve, që ka sjellë për pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH ndaj tyre, në vlerën **108,439,747.08 Euro dhe 59,479,735.64 USD**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Avokatura e Shtetit/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, për këmbimin në kohë të informacionit dhe bashkëpunimin me palët e interesit/ministritë përgjegjëse, në lidhje me procedurat e ndjekura prej tyre për ecurinë e procesit të njohjes së vendimeve nga Gjykata e Apelit, për rastet kur vendimet e arbitrazhit janë shprehur në favor të RSH.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hedhjen e të dhënave në regjistrin e posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, rezultojnë se Regjistri nuk është plotësuar sipas rubrikave të formatit

të miratuar, pasi nuk përmban të dhëna mbi datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes/vendimit për arbitrazh në protokoll, për çështje të iniciuara para vitit 2022 (*kohë në të cilën ka dalë urdhri për miratimin e formatit të Regjistrimit*) për aq sa mund të lejohet nga parimi i konfidencialitetit, si dhe për ekzekutimin e detyrimeve të GJEDNJ si dhe nuk përfshin numrin e kërkesës, në kundërshtim me nenin 17 pika 3, germa “c” dhe nenin 18, pika 1.2, germa “r” të Rregullores dhe formatit të Regjistrimit.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, që hedhja e të dhënave në regjistrin e çështjeve të bëhet konform kërkesave të formatit të miratuar, duke u bërë përditësimi i tij në kohë reale, me qëllim që të dhënat e regjistruara të shërbejnë për raportimin në MFE të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e përkthimit dhe certifikimit të vendimeve GJEDNJ nga Ministria e Drejtësisë, ka rezultuar se për 3 (tre) çështje (“Prodhim veshje nr.2 SHA kundër Shqipërisë”, “N. kundër Shqipërisë” dhe “L. C. kundër Shqipërisë” dhe 4 kërkesa të tjera”) nuk është respektuar afat ligjor brenda 15 ditëve, e cila nuk është në përputhje me nenin 19/2 të Ligjit Nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar .

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë për koordinimin e veprimeve për përkthimin dhe certifikimin në kohë të vendimeve të GJEDNJ, me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit final të tyre, duke shmangur lindjen e interesave për vonesë në ekzekutimin e tyre.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve GJEDNJ, rezultoi se:

- Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat për 21 vendime të dala në vitin 2023, duke përfshirë dhe vendimin ”D. kundër Shqipërisë”, i cili është bërë përfundimtar në vitin 2024, dhe në 6 procedura të vitit 2023 ekzekutimi është bërë jashtë afatit përkatës ligjor.

-Për 3(tre) vendime (D. kundër Shqipërisë-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 14.09.2015, Dh. N. kundër Shqipërisë-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 17.03.2016 dhe S. kundër Shqipërisë, vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 28.05.2018) detyrimi i vendosur nga GJEDNJ vijon të jetë i pa ekzekutuar, duke shkaktuar rritjen e interesave për mos likuidimin në kohë.

- Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë 3(tre) vendime të GJEDNJ-së, të mbartura (“S. kundër Shqipërisë-komunikuar datë 21.01.2020, vendimi përfundimtar datë 21.05.2020”, “P. kundër Shqipërisë- komunikuar datë 11.06.2019, vendimi përfundimtar datë 11.09.2019” dhe “S. kundër Shqipërisë-komunikuar datë 13.12.2022, vendimi përfundimtar datë 13.03.2023”), të cilat kanë sjellë efekt financiar dhe konkretisht interesa në vlerën 410,937 lekë.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të kryhen veprimet me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ brenda afatit ligjor, me qëllim që të shmangen kostot shtesë për buxhetin.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin në MFE, në rrugë zyrtare shkresore dhe elektronike për sa i përket regjistrimit të përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queue), në zbatim të UMF Nr.9 datë 20.03.20218 dhe Nr.2, datë 19.01.2023, rezulton se nga ASH është tejkaluar afati, si dhe nuk është

respektuar forma e kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit, në kundërshtim me këtë akt nënligjor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-26, 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH që në bashkëpunim me MF të bëjë rakordinin e vlerave financiare, që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ, me qëllim raportimin sa më të saktë në realizimin e buxhetit faktik të vitit, për sa i përket detyrimeve financiare që burojnë nga këto vendime të periudhës përkatëse raportuese.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së nuk ka funksionuar në vitin 2023, sipas parashikimeve në nenin 19/8 të Ligjit Nr.10018/2008, i ndryshuar, pasi ka përfunduar mandati i anëtarëve të tij. Emërimi i anëtarit të ri është bërë në vitin 2024, bazuar në Urdhrin nr.91, datë 04.06.2024 të Kryeministrit “Për një ndryshim në urdhrin nr.34 datë 04.02.2019 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ për çështjet e Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut” i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, përbërja e të cilit është plotësuar në vitin 2024 në zbatim të Urdhrit nr.91, datë 04.06.2024 të Kryeministrit, të marrë masa për hartimin e planeve të punës dhe plan veprimet në kuadër të ekzekutimit të vendimeve nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administrojnë ASH për çështjet më poshtë, si dhe nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023 në lidhje me kontabilizimin dhe likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, në subjektet MIE, MTM, AKBN dhe Albpetrol SHA Patos rezulton se:

- Në pasqyrat financiare viti 2023 të **MIE**, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, nuk janë të kontabilizuara vendimet e gjykatave të arbitrazhit ndërkombëtar. Ndërkohë, nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit rezultojnë dy çështje në arbitrazhin ndërkombëtar me palë të paditur MIE:

- ICC Case nr. 22676/GR v. MIE, AKBN & Albpetrol.

- ICC Case No. 20564/EMT k. RSH/MIE.

a. Për çështjen ICC Case 22676/GR kundër MIE, AKBN & Albpetrol datë 06.07.2020 detyrimi i RSH (MIE/AKBN) ndaj paditësit është **12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+interesa**, i cili përbëhet nga:

- 12,577,852.1 USD si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencë Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit;

- Paditësi duhet të paguajë 60 % të kostove administrative dhe të paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove,

-292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, ka njohur dhe ka dhëni fuqi ligjore për zbatim në RSH të Vendimit nr. 22676/GR. Avokatura e Shtetit ka ushtruar rekursin për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, pushimin e gjykimit të çështjes, si dhe pezullimin e ekzekutimit. Pezullimi i ekzekutimit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Aktualisht çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë.

Totali i detyrimeve deri me datë 31.12.2023 i përlllogaritur rezulton të jetë **12,921,664.63 USD dhe 16,971.82 Euro**.

Mosnjohja e vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 49, datë 04.05.2021 në pasqyrat financiare, ka sjellë një paraqitje jo të drejtë të detyrimeve që ka institucioni ndaj palëve të treta si dhe

interesa të cilat shtohen me normë 5% deri në shlyerje, duke sjellë rritje të risqeve financiare për buxhetin e institucionit.

Interesat e përlllogaritura deri me date 31.12.2023 janë 2,520.14 € dhe 51,052.53 USD.

b. Për çështjen ICC Case No. 20564 kundër RSH/MIE, tribunali arbitrazhit shprehet:

- T'i paguhen RSH, penalitetet për vonesa në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë.
- Dëmshtëpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 9.1.2018 deri në pagesën e plotë.
- Rimbursim të RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.
- Detyrim i RSH për t'i rimbursuar Padihtësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën 142,975.78 Euro.

Gjykata e Apelit me vendimin nr. 131, datë 03.05.2023 ka njohur çështjen ICC Case No. 20564/EMT srl kundër RSH/MIE duke i dhënë fuqi ligjore. Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është bërë njohja e këtij vendimi në pasqyrat financiare, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare të të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasoje mos arkëtimin e të drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

- Në pasqyrat financiare viti 2023 të MTM, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, tepricat e llogarive rezultojnë me vlerë 0 (zero) lekë. Ndërkohë, nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit për çështjen ICSID ARB/14/26 kundër RSH/Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, tribunali Arbitrazhit shprehet për detyrimet e palës paditëse:

- 427,488.72 USD, kosto dhe shpenzime të procesit të arbitrazhit, dhe
- 1,857,000 Euro shpenzime gjyqësore (shpenzimet për studion ligjore të kontraktuar, ekspertin)
- 106,755 GBP shpenzime administrative.

Pala paditëse ka iniciuar procesin e anulimit, për të cilin tribunali i arbitrazhit ka dalë me vendim datë 18.04.2022, njoftuar palëve me 6 Maj 2022:

Detyrime të palës paditëse në favor të RSH/MTM janë:

- 409,636.99 USD dhe 550,000 Euro.

Nga përlllogaritja e grupit të auditimit deri me datë 31.12.2023 totali i vlerave të arkëtueshme në favor të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit janë në shumat 5,418,883.31 Euro, 1,472,635.27 USD dhe 265,458.19 GBP.

Nga shpallja e vendimit deri ne datën 31 dhjetor 2023 nga ana e MTM, nuk është marrë asnjë masë për njohjen e vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit për dhënien fuqi ligjore në mënyrë që të bëhet kontabilizimi dhe më pas ndjekja për ekzekutimin e tij.

- Në pasqyrat financiare për vitin 2023, në AKBN, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve është kontabilizuar një vendim arbitrazhi ndërkombëtar. Nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit rezulton një çështje ICC Case 21349/GR e përfunduar, me palë të paditur AKBN, që është e njëjtë me vendimin e kontabilizuar në pasqyrat financiare. Tribunali Arbitrazhit ka dalë me vendim të ndërmjetëm datë 01.02.2018 sipas të cilit:

- AKBN detyrohet t'i paguajnë B. vlerën 1,161,309,37 USD, kostot e përballuara nga B. deri në këtë fazë të procedurave në lidhje me ankimimin.

Deri më datë 31.12.2023 nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore nuk është marrë asnjë masë lidhur me likuidimin apo planifikimin për likuidim të këtij detyrimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Të merren masa nga institucionet palë në proces arbitrazhi (MTM, MIE, AKBN) në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të rakordojnë veprimet duke filluar që nga ndjekja e procedurave ligjore në Gjykatën e Apelit për dhënie fuqi ligjore vendimit të arbitrazhit, me qëllim njohjen e të drejtave dhe detyrime në pasqyrat e tyre financiare, për

ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare, me qëllim likuidimin e detyrimeve dhe marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve në funksion të raportimit që Avokatura e Shtetit bën pranë Ministrisë së Financave për hartimin e Raportit Vjetor për zbatimin e buxhetit faktit.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT